
ORCA
organizata për rritjen e cilësisë në arsim

KONFUZIONI I MADH



Pse nuk përputhet veprimtaria e institucioneve të Arsimit të Lartë me nevojat e tregut të punës ?

KONFUZIONI I MADH



Publikues:
ORCA – Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim
orca-ks.org
info@orca-ks.org
Henrik Bariç, Nr. 6
Prishtina, 10000, Kosova

Editor:
Rron Gjinovci

Autor:
Adea Kondirolli

Asistent në hartimin e raportit:
Dibran Hoxha; Liridona Ademaj; Ilir Konushevci; Skord Retkoceri

Hulumtues:
Adea Kondirolli; Dibran Hoxha; Gramos Buçinca

Prishtinë, prill 2022

TABELA E PËRMBAJTJES

6 SHKURTESAT

7 LISTA E TABELAVE

7 LISTA E FIGURAVE

8 HYRJE

9 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

11 SKEMA E AKTERËVE TË PËRFSHIRË NË ARSIMIN E LARTË

13 TË DHËNAT E PËRMBLEDHURA

19 INSTITUCIONET E SHTETIT NUK KANË POLITIKA ORIENTUESE PËR IAL

19 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë, dhe Inovacionit

19 Agjencia e Kosovës për Akreditim

21 UNIVERSITETI NUK KA POLITIKA ORIENTUESE PËR HARTIMIN E PROGRAMEVE TË REJA

21 Rrjedha e procesit të themelimit të një programi brenda universitetit

23 BIZNESET DHE STUDENTËT PËRGËNJESHTROJNË UNIVERSITETIN

23 **Shpërputhjet mes palëve**

23 Fakulteti Ekonomik – Programi Banka, Financa dhe Kontabilitet

25 Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike – Programi Inxhinieri Kompjuterike

27 Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike – Programi Elektroenergjetikë

29 Fakulteti i Filologjisë – Programi Gazetari

31 **SECILI ME TË VETEN - pyetësori zbulon shpërputhjen mes pritshmërive të studentëve dhe asaj që ofrohet në Universitet**

31 Fakulteti Ekonomik – Programi Banka, Financa dhe Kontabilitet

34 Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike – Programi Inxhinieri Kompjuterike

38 Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike – Programi Elektroenergjetikë

42 Fakulteti i Filologjisë – Programi Gazetari

46 METODOLOGJIA

46 **Pyetësori**

47 **Intervistat**

SHKURTESAT

UP	Universiteti i Prishtinës
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
AKA	Agjencia e Kosovës për Akreditim
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
KSHC	Këshilli Shtetëror i Cilësisë
RVV	Raporti i Vetëvlerësimit
ORCA	Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim

LISTA E TABELAVE

32 **TABELA 1.** Përgjigjet e studentëve të programit Banka, Financa, dhe Kontabilitet, se sa pajtohen që janë arritur rezultatet e të nxënit të programit

35 **TABELA 2.** Përgjigjet e studentëve të programit Inxhinieri Kompjuterike se sa pajtohen që janë arritur rezultatet e të nxënit të programit

39 **TABELA 3.** Përgjigjet e studentëve të programit Elekroenergjetikë se sa pajtohen që janë arritur rezultatet e të nxënit të programit

43 **TABELA 4.** Përgjigjet e studentëve të programit Gazetari se sa pajtohen që janë arritur rezultatet e të nxënit të programit

47 **TABELA 5.** Të dhënat rreth studentëve të anketuar

47 **TABELA 6.** Të dhëna rreth të intervistuarve

LISTA E FIGURAVE

14 **FIGURA 1.** Arritja e rezultatit të të nxënit në BFK

15 **FIGURA 2.** Arritja e rezultatit të të nxënit në Inxhinieri Kompjuterike

16 **FIGURA 3.** Arritja e rezultatit të të nxënit në Elektroenergjetikë

17 **FIGURA 4.** Arritja e rezultatit të të nxënit në Gazetari

24 **FIGURA 5.** Informimi rreth programit Banka, Financa, dhe Kontabilitet para fillimit të studimeve

26 **FIGURA 6.** Informimi rreth programit Inxhinieri Kompjuterike para fillimit të studimeve

28 **FIGURA 7.** Informimi rreth programit Elektroenergjetikë para fillimit të studimeve

30 **FIGURA 8.** Informimi rreth programit Gazetari para fillimit të studimeve

33 **FIGURA 9.** Sfidat e studentëve të programit Banka, Financa, dhe Kontabilitet në arritjen e qëllimeve të tyre në karrierë

34 **FIGURA 10.** Nevojat e studentëve të programit Banka, Financa, dhe Kontabilitet për përmirësim para hyrjes në treg të punës.

37 **FIGURA 11.** Sfidat e studentëve të programit Inxhinieri Kompjuterike në arritjen e qëllimeve të tyre në karrierë

38 **FIGURA 12.** Nevojat e studentëve të programit Inxhinieri Kompjuterike për përmirësim para hyrjes në treg të punës.

41 **FIGURA 13.** Sfidat e studentëve të programit Elektroenergjetikë në arritjen e qëllimeve të tyre në karrierë.

42 **FIGURA 14.** Nevojat e studentëve të programit Elektroenergjetikë për përmirësim para hyrjes në treg të punës.

44 **FIGURA 15.** Sfidat e studentëve të programit Gazetari në arritjen e qëllimeve të tyre në karrierë.

45 **FIGURA 16.** Nevojat e studentëve të programit Gazetari për përmirësim para hyrjes në treg të punës.

HYRJE

Raporte të ndryshme ndërkombëtare dhe vendore thonë se aftësitë e fituara të studentëve (18 deri 23 vjeç) në Kosovë, nuk përkojnë me nevojat e tregut të punës. Sipas një raporti të Bankës Botërore të 2017- ës, "Në Kosovë, fuqia punëtore pa edukim dhe aftësim adekuat, mbetet pengesë veçanërisht për kompanitë e mëdha dhe ato me rritje të shpejtë – si pasojë duke e zbutur zhvillimin dhe duke shkaktuar kosto sociale në kuptim të humbjes së punësimit".[1] Për më tepër, i njëjti raport thekson se "Shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore në Kosovë me 37.6% në vitin 2015 është më e ulët se mesatarja e rajonit me 70%".[2]

Raporti i progresit për Kosovën në vitin 2021 evidenton që "shumë pak progres është bërë në përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe adresimit të mangësive të shkathtësive në tregun e punës".[3] Ky raport po ashtu evidenton që shkalla e lartë e mospjesëmarrjes në treg të punës (61.7%), e sidomos te gratë (79.2%) dhe te rinia (49.1% për moshat 15-24) tregon për probleme strukturore si mospërputhja mes rezultateve të të nxënit dhe nevojave të tregut.[4]

Të dhëna të ngjashme janë publikuar nga entitete të ndryshme, si për shembull, një studim nga Instituti Riinvest i vitit 2021, evidentohet se punëdhënësit vlerësojnë që të diplomuarve ju mungojnë shkathtësitë e nevojshme.[5] Sidoqoftë një hulumtim i detajuar, që ka për qëllim identifikimin e shkaqeve të sakta të këtij fenomeni, nuk është bërë asnjëherë.

Në këtë raport, ORCA ka hulumtuar përputhshmërinë e rezultateve të të nxënit në katër programe (Banka, financa dhe kontabilitet; Elektroenergjetikë; Inxhinieri Kompjuterike; Gazetari) me nevojat e tregut në këto katër fusha. Në hulumtim janë përfshirë studentët, profesorët, menaxhmenti i fakulteteve respektive dhe i Universitetit të Prishtinës, zyrtarë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, dhe përfaqësues të kompanive të fushave respektive.

Në përgjithësi asnjë institucion në Kosovë nuk bën studim të tregut të punës, duke përfshirë Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA), Universitetin e Prishtinës (UP), apo njësitë akademike brenda UP-së. Të dhënat rreth tregut të punës, Universiteti i Prishtinës, pretendon që i merr nga Bordet Industriale (thënë ndryshe Trupa Këshillëdhënëse) të përbëra nga përfaqësues të industrisë. Bazuar në intervista me 10 kompani të katër fushave të përzgjedhura për këtë hulumtim, asnjëra nuk është ftuar të marrë pjesë në këto trupa, ose në ndonjë takim për ofrimin e komenteve ose këshillave të tyre rreth programeve. Kompanitë e intervistuara përfaqësojnë kompanitë më të mëdha në secilin sektor që përket me programet fokus të këtij studimi.

1 "Republic of Kosovo Systematic Country Diagnostic", World Bank, 2017, fq. 11, linku: https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/26573/Kosovo-SCD-FINAL-May-5-C-05052017.pdf
2 Ibid. Fq. 103.
3 "Kosovo* 2021 Report", European Commission, 2021, fq. 7, linku: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021_en
4 Ibid. Fq. 59.
5 "Employment and Labour Market Analysis", Instituti Riinvest, 2021, linku: https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2021/October/05/Employment-and-Labour-Market-Analysis-ENG1633434888.pdf

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

A ka shteti plan për zhvillim ekonomik e social? Si nuk arrijnë institucionet t'i kryejnë funksionet e veta? Si mbetet pa u lidhur tregu i punës me aftësitë e fituara nga studentët në institucionet e Arsimit të Lartë në Kosovë?

Për të gjetur shkakun e mospërputhjes së tregut të punës me aftësitë e fituara duhet shqyrtuar përfshirjen e palëve në procesin e përgatitjes së kuadrit për tregun e punës. Në këtë proces që mbështetet në masën më të madhe nga taksapaguesit, qoftë direkt, qoftë indirekt, janë 3 institucione që në mënyrë direkte janë përgjegjëse për krijimin e kushteve dhe infrastrukturës së studimeve. Ministria e Arsimit, Universiteti dhe Agjencia e Kosovës për Akreditim në bashkëveprim të ngushtë prodhojnë politika arsimore, programe studimi dhe kushte për studim për studentët në Kosovë. Të tria këto janë të supozuara që në forma të ndryshme ta analizojnë tregun e punës me qëllim që t'i përmirësojnë defiçiencat e studentëve të diplomuar ashtu që të përmirësohet kualiteti i aftësive të fituara dhe që ato aftësi të jenë sa më në përputhje me nevojat e tregut të punës.

MAShT duke përfaqësuar Qeverinë në këtë proces, pra ministritë e ndryshme që mund të kenë role të caktuara në çështjet që lidhen me tregun e punës, do të duhej të kishte rolin e përcaktimit të orientimeve dhe drejtimit të politikave shtetërore afatshkurta, afatmesme dhe afatgjata. Këtu do të mund të hynte orientimi i kapaciteteve arsimore kah një lloj i shkencës apo drejt zhvillimit të një profesioni që Ministria do ta prioritizonte, si vie fjala programimi kompjuterik si një profesion i së ardhmes, apo vendosja e targeteve në zhvillimin e arsimit që ka të bëjë me agrikulturë dhe agrobiznes, apo të ngjashme.

AKA si një mekanizëm zbatues i politikave arsimore dhe hartimit të politikave të sigurimit të cilësisë, e drejtuar nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë i cili ka në tagrin e vet mbikëqyrjen e sigurimit të cilësisë dhe hartimin e politikave për sigurimin e cilësisë në Arsimin e Lartë, do të duhej që këto orientime shtetërore t'i zbërthente në objektiva më konkrete si vie fjala në përcaktim të llojit të programeve që do të lejojnë më shumë kuota regjistrimi të studentëve, bie fjala në programim kompjuterik apo në agrikulturë.

Universiteti (institucionet publike të Arsimit të Lartë në Kosovë) si njësia më e vogël zbatuese do të duhej që në harmoni me politikën shtetërore të përcaktuar nga MAShT dhe përcaktimet e objektivave të sigurimit të cilësisë nga AKA, t'i përkthente në programe konkrete studimi me qëllime specifike. Po ashtu do të duhej që universitetet të synonin profilizimin për të përfaqësuar në njëfarë forme orientimet afatgjate shtetërore, bie fjala Universiteti i Pejës të synojë profilizimin kah agrobiznesi për t'iu përgjigjur territorit ku vepron; Universiteti i Prizrenit të ketë më shumë programe të shkencave sociale dhe humane që studiojnë kulturën dhe njeriun për t'iu përshtatur kontekstit social multikulturor; ai i Mitrovicës metalurgjisë dhe ambientin si rrjedhojë e punës së Trepçës; ndërkohë Universiteti i Prishtinës do të ruante drejtimet ekzakte shkencore dhe ato të mjekësisë duke iu përgjigjur kapaciteteve të pakrahasueshme me universitetet tjera.

Të tria këto institucione do të duheshin pasur një bashkëpunim të ngushtë me botën e biznesit. Secila sipas rolit dhe funksionit të vet. **Ministria e Arsimit** si përfaqësuese e Qeverisë në këtë proces, përmes ministrive tjera përkatëse do të mund të ofronte analiza të detajuara të tregut të punës, trendeve të tij dhe nevojave afatmesme e afatgjata të vendit për zhvillim

ekonomik. **Universitetet** do të duheshin analizuar shkallën e punësimit të studentëve të tyre dhe atë se a ka përshtatje të të diplomuarve me vendin e punës, pra inxhinieri a punësohet si inxhinier apo në ndonjë profesion tjetër. Kësisoj Universitetet do të ishin në gjendje të përmirësonin praktikën e tyre akademike si dhe të ngushtonin hendeqet mes aftësive të fituara me nevojat e tregut të punës. **Agjencia** do të duhej të siguronte publikun se këto shkëmbime janë në përputhje me orientimet shtetërore dhe me planet afatmesme e afatgjata të shtetit në krijimin e kuadrove të reja dhe zhvillimit ekonomik.

Një detyrë e veçantë e MAShTI mbetet hartimi i planeve për subvencionimin e drejtimeve të cilat mund të mos kenë treg të punës (në Kosovë), por që janë kruciale për shoqërinë siç mund të jenë artet pamore, filozofia, muzika apo ndonjë shkencë e cila nuk përfaqësohet nga sektori industrial në Kosovë.

Shteti pa plan zhvillimi ekonomik e social

Përmes këtij studimi ORCA ka evidentuar se Qeveria dhe MAShT ende nuk e kanë të qartë cilat janë orientimet e mëdha të shoqërisë Kosovare për zhvillimin ekonomik të saj, ndonëse në këtë drejtim po punohet. Ajo që duhet theksuar është se "strategjitë" që janë hartuar deri tash zakonisht përmbajnë një numër të madh targetesh që duhen arritur apo që duhen përmirësuar, por që nuk përfaqësojnë një vizion të qartë të transformimit ekonomik e social në Kosovë. Si shembull, lexuesi i këtij studimi mund të ketë dëgjuar për nevojën që Kosova të shkojë drejt prodhimit, por askush nuk di të tregojë prodhimit të çkafit, apo edhe nëse dihet lloji i prodhimit asnjë dokument nuk mund të sqarojë pse dhe si do të rezultojë në një projekt të suksesshëm ekonomik ai lloj prodhimi që Kosova do të mund ta prodhonte në të ardhmen.

Agjencia pa objektiva konkrete si rrjedhojë e mungesës së një plani shtetëror

Si rrjedhojë, Agjencia është e limituar në hartimin e ndonjë politike konkrete duke u fokusuar më shumë të ruajtja e një cilësie të përgjithshme të asaj që tashmë ekziston, rritja e cilësisë në të ardhmen në hartimin e programeve dhe mbikëqyrjen sa më të mirë të zbatimit të tyre. Mund të thuhet se Agjencia po kryen punën e saj sipas rrethanave në të cilën ndodhet, ndërkohë që ORCA vëren se në momentin e dhënies së ndonjë udhëzimi për të ndërruar kurs në kuptimin e konkretizimit të politikave ekzistuese, Agjencia ka vullnet, kapacitete dhe dinamikën e nevojshme për t'u përshtatur dhe për të qenë e suksesshme në ekzekutimin e funksioneve të saj.

Institucionet e Arsimit të Lartë në letargji si pasojë e mungesës së kontrollit shtetëror

Institucionet e Arsimit të Lartë në anën tjetër, duke mos pasur detyrime për të mbledhur informacione për studentët e tyre të diplomuar, ka mbetur në vullnetin e rektorëve dhe se sa vizionarë mund të jenë ata në zbutjen e hendekut të aftësive të fituara të studentëve me nevojat e tregut të punës. Universitetet dhe në përgjithësi institucionet e arsimit të lartë në Kosovë nuk kanë asnjë kushtëzim për të pasur lista të alumnive, për të gjeneruar të dhëna të punësimit të ish studentëve të tyre apo të tjera të ngjashme. ORCA mendon se informacione të tilla do të duheshin bërë kusht për licencimin e tyre vit pas viti. Në këtë mënyrë do të gjeneroheshin informacione të një kualiteti solid dhe të besueshme që sot nuk i posedon askush në Kosovë.

Bizneset e painteresuara për të kontribuar në përmirësimin e aftësive të studentëve

Bizneset në anën tjetër, me shumë pak përjashtime nuk kanë një kulturë të mirëfilltë të kontributit në shoqëri si diçka nga e cila ato do të përfitonin. Si shembull, bankat presin që një i diplomuar në Universitet të dijë të bëjë punën në kasë, ndërkohë që nuk kanë ofruar ndonjë bashkëpunim me universitetet për të ofruar financimin e klasave (lëndëve zgjedhore) me qëllim të ngritjes së këtij kapaciteti për studentët. Në fakt, bizneset siç janë bankat, ndonëse operojnë në një hapësirë ku aftësitë e fituara nuk janë përgjithësisht të kënaqshme me nevojat e tregut të punës, ato janë përfituesi më

i madh kur kemi parasysh profitin, përthithjen e punëtorëve më të mirë që i prodhon sistemi arsimor (sidomos atyre nga drejtimet matematikore dhe të programimit kompjuterik), krahasuar me angazhimin e tyre minimal në jetën universitare në vend.

Qeveria do të mund të luante një rol me rëndësi në rritjen e këtij angazhimi të botës së bizneseve duke prodhuar lehtësira të ndryshme tatimore për bizneset që kontribuojnë në zhvillimin universitar publik në vend.

SKEMA E AKTERËVE TË PËRFSHIRË NË ARSIMIN E LARTË





Një detyrë e veçantë e MAShTI mbetet hartimi i planeve për subvencionimin e drejtimeve të cilat mund të mos kenë treg të punës (në Kosovë), por që janë kruciale për shoqërinë siç mund të jenë artet pamore, filozofia, muzika apo ndonjë shkencë e cila nuk përfaqësohet nga sektori industrial në Kosovë.



43%

e studentëve të vitit të tretë kanë thënë që nuk janë informuar paraprakisht për aftësitë të cilat do t'i fitojnë në programet e studimit që kanë zgjedhur.

TË DHËNAT E PËRMBLEDHURA

Gjysma e studentëve të vitit të parë kanë shprehur që nuk janë informuar paraprakisht për aftësitë të cilat do t'i mësojnë në programet e studimit që kanë zgjedhur. Gjysma tjetër, të cilët deklarojnë që janë informuar, burimin kryesor të informacionit e kanë familjen, shoqërinë të cilët kanë studiuar të njëjtin program më herët, e shumë pak janë informuar nga profesorët ose nga institucionet.

Më pak se gjysma (43%) e studentëve të vitit të tretë kanë thënë që nuk janë informuar paraprakisht për aftësitë të cilat do t'i fitojnë në programet e studimit që kanë zgjedhur. Njëjtë si kolegët e tyre të vitit të parë, burimi kryesor i informacionit për ata që kanë thënë se janë informuar, ka qenë familja dhe shoqëria, dhe një pjesë kanë cituar profesorët si burim informacioni.

SA I PËRKET VETËRAPORTIMIT NGA STUDENTËT PËR ARRITJEN E REZULTATEVE TË TË NXËNIT TË PROGRAMIT, NË VIJIM JANË DISA NGA REZULTATET MË DOMETHËNËSE:

BANKA, FINANCA, DHE KONTABILITET:


REZULTATI I TË NXËNIT:

“Zhvillojnë kompetencat metodologjike të nevojshme për të kuptuar në mënyrë adekuate gjetjet e reja shkencore në ekonomi, të realizojnë hulumtime dhe të vazhdojë tutje studimet në programin Master.”



FIGURA 1.

Arritja e rezultatit të të nxënit në BFK



INXHINIERI KOMPJUTERIKE:


REZULTATI I TË NXËNIT:

“Analizon kërkesat e TI-së duke marrë parasysh nevojat e konsumatorëve dhe zbatoj këto kërkesa në një mënyrë praktike”



FIGURA 2.

Arritja e rezultatit të të nxënit në Inxhinieri Kompjuterike



ELEKTROENERGJETIKË:

REZULTATI I TË NXËNIT:

“Përgatitë studentë për karrierë profesionale dhe studime të mëtejme në fushën e inxhinierisë elektrike, lëminë e elektroenergjetikës”





FIGURA 3.

Arritja e rezultatit të të nxënit në Elektroenergjetikë



GAZETARI:


REZULTATI I TË NXËNIT:

“Mësimi i teorive kryesore të studimit të medias përmes lëndëve Bazat e Komunikimit Masiv”



FIGURA 4.

Arritja e rezultatit të të nxënit në Gazetari



Programi i Gazetarisë i ka të bazuara rezultatet e të nxënit në aftësi të mësuara në lëndë specifike, dhe nuk janë të krahasueshme me programet e tjera të cilët janë të formuluara sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe Taksonomisë së Blumit.

Në përgjithësi:

- Programet në universitete nuk kanë plan zhvillimi në aspektin e industrisë ose shkencës, dhe nuk ka ndonjë dallim në akreditim për këto lloje programesh.
- Agjencia e Kosovës për Akreditim nuk ka pasur deri tani mjaftueshëm staf ose mekanizma ligjor për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve të ekspertëve rreth programit të akredituar.
- Studentët nuk konsultohen aktivisht për vlerësimin e lëndëve, programit, rishikimin e programit, apo hartimin e tij. Pjesëmarrja e tyre është sipërfaqësore përmes pyetësorëve të vlerësimit apo takimeve me ekspertë të akreditimit.
- Puna praktike nuk është obligative në të gjitha programet e studimit në universitet, specifikisht është obligative vetëm në gjysmën e programeve të shqyrtuara në këtë hulumtim.
- Universiteti dhe njësitë akademike nuk kanë plan ose marrëveshje të mirëfillta me ligjërues mysafirë që mund të ndajnë përvojat e tyre nga universitetet tjera ose nga industria me studentët.
- Ndërkombëtarizimi i programeve mbetet në nivelin e shkëmbimeve përmes Erasmus+ dhe Fulbright.
- Planprogramet janë në përputhshmëri me standardet profesionale dhe Kornizën Kombëtare te Kualifikimeve sipas menaxhmentit dhe profesorëve, por kjo nuk konfirmohet nga të gjitha kompanitë e intervistuara të cilat tregojnë për mungesë të konkretizimit të pjesës teorike në aspektin praktik. Specifikisht, te programi Banka dhe Financa, kompanitë janë të pakënaqura edhe me nivelin teorik të studentëve, si dhe atë praktik.
- Pritshmëritë e studentëve për aftësitë që do mësojnë janë në përputhje me rezultatet e të nxënit, por këto nuk arrihen plotësisht në fund të studimeve.
- Ka mungesë të theksuar të literaturës në gjuhën shqipe, por ka mjaftueshëm në gjuhën angleze.
- Pavarësisht që studentët mendojnë në përqindje të madhe që dinë të shkruajnë CV dhe letër motivimi, kjo nuk konfirmohet nga profesorët, menaxhmenti i universitetit, dhe nga kompanitë ku ata punësohen.
- Studentët kanë përzgjedhur fushat e tyre të studimit për shkak se ju pëlqen ai drejtim dhe duan të punojnë në atë fushë, ose për arsye financiare.
- Asnjë nga institucionet e përfshira në këtë raport nuk bëjnë matje të vazhdueshme të punësimit të studentëve në fushën e tyre. Disa matje bëhen herë pas here në nivel të departamentit ose Zyrës për Zhvillim Akademik.
- Ka hendeqe të theksuara mes institucioneve të arsimit të lartë dhe kompanive që punësojnë studentët e diplomuar nga këto institucione. Një bashkëpunim më i afërt përmes mekanizmave ekzistuese ose të reja është tejet i nevojshëm, në mënyrë që të mbyllen këto hapësira.

INSTITUCIONET E SHTETIT NUK KANË POLITIKA ORIENTUESE PËR IAL

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË, DHE INOVACIONIT

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë, dhe Inovacionit (MASHTI) deri tani nuk ka pasur politika të qarta orientuese që e ndërlidhin arsimin me tregun e punës. Në Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021, konstatohet se ka mungesë të informatave nga tregu i punës dhe se ekziston shpërputhje e madhe ndërmjet arsimit të lartë dhe tregut të punës.

"Përkundër disa përparimeve në zhvillimin e praktikës së mbledhjes së të dhënave të tregut të punës dhe hartimit të Strategjisë për Arsim dhe Këshillim në Karrierë 2015-2019, mungesa e orientimit dhe qendrave të këshillimit të karrierës në shkollë, në nivel komunal dhe në nivel kombëtar, si dhe mungesa e informatave nga tregu i punës, mbeten sfida të rëndësishme"[6].

Ky dokument rekomandon disa zgjidhje për eliminimin e kësaj shpërputhjeje por se nuk ka asnjë rezultat konkret që është bërë në këtë drejtim. Si rrjedhojë, as Agjencia e Kosovës për Akreditim dhe as universitetet publike nuk e kanë të mundur hartimin e politikave më të detajuara orientuese.

AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM

AKA është autoriteti i vetëm në Kosovë që bën sigurimin e cilësisë të arsimit të lartë. Kjo agjenci ka bordin e quajtur Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC), që bën politikat dhe merr vendimet në agjenci. AKA e bën vlerësimin e programeve me ekspertë ndërkombëtarë, të cilët e bëjnë vlerësimin në bazë të standardeve të zhvilluara nga AKA dhe të miratuara nga KShC.

Agjencia e Kosovës për Akreditim nuk ka politika orientuese mbi programet që akreditohen, sipas përfaqësuesve të këtij institucioni. Akreditimi i programeve bëhet në bazë të 7 standardeve për akreditim dhe rekomandimeve të ekspertëve ndërkombëtarë mbi plotësimin e atyre standardeve, të cilët bazohen në Raportet Vetëvlerësuese të programeve/universiteteve.

Njëra nga standardet për akreditim institucional dhe të programit është ndërlidhja me tregun e punës.

Agjencia e Akreditimit nuk ka një sistem të peshuar të standardeve, që nuk do lejonte akreditimin e një programi për të cilin nuk ka nevojë në treg, për sa kohë që i plotëson standardet tjera. Të gjitha standardet janë të barabarta, nuk ka standard që peshon më shumë se tjetri, ose ndonjë që është përjashtues.

6 "Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021", 2016, fq. 28,linku: https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-psak-2017-2021_1.pdf

> *"p.sh. prej 7 standardeve, në momentin që i plotëson 5 standarde, akreditohesh. Po çka ndodh në rastet, kur standardi i stafit akademik edhe tregun e punës nuk i plotëson? Qysh mundesh me hap një program akademik pa staf akademik? ... Por nëse nuk ki staf akademik, ti nuk mundesh as me fillu."*
> – PËRFAQËSUES I AKA

Rezulton që akreditimi i një programi nuk varet as nga nevojat e Kosovës për një kategori të caktuar studimesh (apo profesionesh), as nga ndonjë matje empirike e ekspertëve lidhur me këtë çështje, pasi nuk ekziston referenca bazë. Për më tepër, edhe në rastet kur institucionet raportojnë në RVV se bazohen në kërkesën e tregut, nuk kërkohet evidencë që vërteton një gjë të tillë. Gjithçka bazohet në aftësitë bindëse të atyre që bartin programin para ekspertëve.

Për akreditim të programeve kërkohet nga universitetet që të paraqesin në Raportin e Vetëvlerësimit (RVV) bashkëpunimin me industrinë. Pas vlerësimit të RVV-së, ekspertët vizitojnë institucionin ku takohen me përfaqësues të industrisë dhe i pyesin ata për përfshirjen e tyre gjatë përpilimit të programit dhe sa i përket përshtatshmërisë së të diplomuarve që punësohen në ato kompani.

> "Nuk mundem me thonë specifikisht që kërkohen të dhëna, megjithatë, RVV, vlerësimi dhe rekomandimi për akreditim, këto të treja duhet të përfshijnë komponentën e tregut të punës. Tash i takon institucionit të arsimit të lartë se cilat të dhënat i mbledh ajo për t'i bind ekspertët ndërkombëtar se një program, një profil i caktuar, ka nevojë në tregun e punës në Kosovë. I takon institucionit të arsimit të lartë që t'i bind ekspertët, dhe sa më shumë të dhëna, duke përfshirë ASK, statistikat e Bankës Qendrore, të Doganave, të Ministrisë së Financave dhe të plot institucioneve tjera që grumbullojnë të dhëna për tregun e punës në Kosovë, sa më shumë që përfshinë."
> – PËRFAQËSUES I AKA

AKA nuk bën matje të punësimit të studentëve në fushën e studimit të tyre. Agjencia nuk ka databazë për studentët e diplomuar që janë tepricë në treg, dhe supozojnë që duhet të ekzistonte brenda Ministrisë së Arsimit. MAShTI po ashtu nuk posedon të dhëna të tilla për kërkesën e tregut, pasi që nuk bëjnë studime gjurmuese sistematike për studentët e diplomuar. Agjencia e Akreditimit ka realizuar një analizë tematike në vitin 2021 për përgatitjen e të diplomuarve kosovarë për tregun e punës, nga perspektiva e punëdhënësve dhe të diplomuarve. Në këtë analizë thuhet se mbi 90% e kompanive dhe organizatave të anketuara kanë shfaqur interes për të bashkëpunuar me institucionet e arsimit të lartë përmes marrëveshjeve të mirëkuptimit, sidomos në dizajnimin e kurrikulave dhe programeve të studimit[7].

Agjencia e Akreditimit për momentin nuk ka mjaftueshëm staf për të bërë monitorimin e programeve, dhe rrjedhimisht nuk mat performancën e tyre, përveç kur akreditohet çdo 3 ose 5 vjet. Të intervistuarit kanë lënë të kuptohet se procesi i akreditimit, për sa i përket pjesëve ku pretendohet dhënia e aftësive të caktuara për studentët si dhe arritja e qëllimeve të programit, ka një natyrë burokratike të përmbushjes së normave dhe jo evidentim të kushteve të institucionit që ofron programi.

7 "Thematic Analysis: Preparation of the Kosovar Graduates for the Labor market - Employer and Alumni Perspective", Agjencia e Akreditimit e Kosovës & WUS Kosova, 2021.

UNIVERSITETI NUK KA POLITIKA ORIENTUESE PËR HARTIMIN E PROGRAMEVE TË REJA

Në nivel universiteti janë intervistuar dy prorektorë të Universitetit të Prishtinës për aspektin e tyre të menaxhimit të programeve dhe përputhjes së tyre me tregun e punës.

Në vazhdim do të paraqiten pretendimet e tyre lidhur me vendimmarrjen për themelimin e programeve të reja. Sipas tyre, kërkesa për programe të reja vjen përmes njërit nga kanalet e mëposhtme:

1. Kërkesa e tregut të punës që kuptohet përmes raporteve të ndryshme; 2. Planifikimi akademik në departamente të cilët propozojnë programe të reja bazuar në kërkesat e tregut por edhe në strategji zhvillimore të UP-së; 3. Projektet ndërkombëtare të bashkëpunimit me universitete partnere.

Rrjedha e procesit të themelimit të një programi brenda universitetit

Procesi i akreditimit për një program fillon me propozimin e grupit punues në nivel të njësisë akademike të cilët punojnë në një Raport Vetëvlerësimi për një program studimor, bazuar në standardet e Agjencisë së Kosovës për Akreditim. Ky RVV aprovohet në njësi akademike, në zyrën për zhvillim akademik të Universitetit, Komisionin për Sigurimin e Cilësisë në Senat, Komisionin për Studime të Senatit, dhe në fund miratohet në Senatin e Universitetit të Prishtinës.

Me gjithë këto filtra brenda Universitetit, shpërputhja e aftësive të fituara nga studentët me nevojat e tregut të punës, tregon që procesi është thjesht dhe vetëm një formalitet burokratik i cili nuk shqyrton përmbajtjen.

Prorektorët theksuan që kur vjen kërkesa nga departamentet për hapjen e programeve të reja nuk mund të jetë për shkak të plotësimit të fondit të orëve për profesorë të caktuar në departamente. Kërkesa mund të ndodhë, sipas tyre, por ai program nuk do t'i kalojë filtrat e sigurimit të cilësisë në Universitetin e Prishtinës. Njëri nga filtrat është krahasueshmëria me programe ndërkombëtare që ofrohen nga institucionet simotra në këtë fushë. Pra programi duhet të ketë krahasim sa i përket përmbajtjes së rezultateve të pritura të nxënies, objektivave, ngarkesës së studentëve etj.

> "...por assesi p.sh. nuk mund të lejohet me u fillu një program studimi nëse nuk ka personel adekuat për atë fushë studimi. Edhe ajo do ishte një aventurë akademike e pambështetur me personel të caktuar akademik." – PROREKTOR NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS

Ky konstatim mbetet i pambështetur kur kemi parasysh faktin që profesorët në Universitetin e Prishtinës japin nga 8 e më shumë lëndë të fushave të ndryshme vetëm duke parë oraret e ligjëratave që zhvillohen në Universitet.

Rrjedhimisht, konstatimi i prorektorëve se pa personel adekuat të fushës së studimit nuk mund të akreditohen programet është i paqëndrueshëm.

Për më tepër këtë konstatim të ORCA-s e mbështet fakti që për një çështje të tillë rregulla të vendosura dhe të zbatueshme nuk ka.

Studimet e mëparshme të ORCA-s[8] tregojnë se mbinormat që janë honorare për orë shtesë, janë tejet të larta ndonëse në rënie, dhe kjo tregon se improvizimet në syllabuse dhe në angazhim të stafit akademik në UP, janë në fakt standardi dhe jo përjashtimi.

Sipas raportit të ORCA-s mbi menaxhimin e financave në universitete publike, në vitin 2019 mesatarja e të ardhurave mujore ishte 2 mijë e 177 Euro, në vitin 2020 kjo ka rënë në 1 mijë e 979 Euro, ndërsa në vitin 2021 kjo shumë ka vazhduar rënien deri në 1 mijë e 625 Euro. Ndërkaq shtesat mujore gjithashtu kanë pësuar një rënie drastike nga 886 Euro sa ishin në vitin 2019, në 699 Euro gjatë vitit 2020 dhe tani mesatarja ka rënë në 371 Euro.[9]

8 "Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës - Menaxhimi i Financave", janar 2020, linku: http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/01/01-Shpenzimet-e-universiteteve-publike-ALB-01.pdf
"Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës - Menaxhimi i Financave 2", tetor 2020, linku: http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/10/Menaxhimi-i-financave-2.pdf
"Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës - Menaxhimi i Financave 3", tetor 2021, linku: http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2021/11/Menaxhimi-i-financave-3.pdf

9 "Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës - Menaxhimi i Financave 3, tetor 2021, linku: http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2021/11/Menaxhimi-i-financave-3.pdf

BIZNESET DHE STUDENTËT PËRGËNJESHTROJNË UNIVERSITETIN

Në këtë kapitull do trajtohen pikëpamjet e studentëve rreth aftësive që ata presin të mësojnë dhe ato që i kanë mësuar në programet respektive në universitet. Po ashtu, do trajtohen edhe pikëpamjet e bizneseve të intervistuara në fushat respektive të studimit, për bashkëpunimin e tyre me universitetin, si dhe aftësitë që i kërkojnë ata në vend të punës nga të punësuarit (studentët).

SHPËRPUTHJET MES PALËVE

Fakulteti Ekonomik – Programi Banka, Financa dhe Kontabilitet

Pretendimet në Fakultetin Ekonomik janë se nevoja për të hapur një program të ri bazohet në kërkesat e tregut, sipas menaxhmentit të këtij fakulteti. Apo se hapja dhe vazhdimi i programeve nuk varet nga numri i orëve për profesorë, por në kërkesën e tregut dhe të studentëve për atë program. Sipas menaxhmentit të fakultetit, ka pasur raste kur janë mbyllur programe ose departamente sepse nuk ka pasur interesim për to.

Profesorët e këtij programi thanë që ka nevojë në treg të punës për kontabilistë dhe financierë gjithmonë. Sipas tyre, konsultimi i bizneseve gjatë hartimit të programit nuk shkon përmes takimeve formale, por përmes të dhënave statistikore të qasshme për publikun. Por që kërkesa në treg është mjaftueshëm e lartë për të justifikuar programin Banka, Financa dhe Kontabilitet. Megjithatë, në Kosovë ka mungesë të të dhënave që saktësojnë kërkesën për profile të ndryshme.

Përfaqësuesit e kompanive kanë thënë që janë ftuar dy herë nga Universiteti i Prishtinës, por në mënyrë ad-hoc dhe jo për komentim të thellësishëm të programit.

> "Kam përvojë 14 vjeçare dhe vetëm para 1 viti, pak para pandemisë një profesor në programin e nivelit Master (plan me bankën qëndrore), na ka ftuar për të folur rreth nevojës për këtë profil në një panel me të huaj. Kjo ftesë ishte ad-hoc, sa për t'i mbështetur. Kjo ka qenë kur i kanë pasur ekspertët e akreditimit prezent, pra kërkonin input nga ne por kjo nuk ishte e planifikuar më herët." – PËRFAQËSUES NGA BANKA.

Programi i Banka, Financa, dhe Kontabilitet në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës është ndarë tashmë në dy programe: Banka dhe Financa, dhe programi Kontabilitet. Të anketuarit janë nga të dy programet për shkak të ngjashmërive mes programeve. Profesorët dhe menaxhmenti i këtij programi dhe fakulteti thonë që programet janë të ndërtuara në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe që planprogramet janë të harmonizuara me standarde ndërkombëtare profesionale.

Syllabuset e programit sipas profesorëve dhe menaxhmentit të Banka, Financa, dhe Kontabilitet ndërtohen nga profesorët e lëndëve përkatëse, mbi standardet ndërkombëtare. Po ashtu, planprogramet zakonisht adaptohen nga universitete të rajonit ose nga vendet e BE-së.


> "..zakonisht na programet i marrim prej dikahit. Varësisht, me ndonjë universitet me të cilin kemi bashkëpunim, edhe i adoptojmë për ne, në përgjithësi programet. Programet si të tilla nëse i merr p.sh. Banka dhe Financa, Kontabilitet, Ekonomiks, programet nuk mendoj që janë të këqija dhe që janë jokonsistente me programet që ofrohen edhe në universitetet tjera." – PROFESOR NË FAKULTETIN EKONOMIK.

Në pikëvështrimin tonë "i marrim prej dikahit" do të thotë kopjim i programeve me qëllim të bindjes së ekspertëve ndërkombëtarë për të fituar akreditimin e programit pa analizuar nevojat e tregut të punës. Kjo është e mundur në saje të mungesës së strukturuar të shqyrtimit të plotësimit të standardeve nga ana e Agjencisë së Kosovës për Akreditim, e cila ndodhë pasi institucionet tjera të shtetit nuk kanë krijuar asnjë lloj orientimi apo analize për nevojat e tregut të punës.

Studentët e vitit të tretë të këtij programi janë pyetur nëse janë informuar paraprakisht nga dikush për programin dhe aftësitë që do i marrin pas përfundimit të studimeve, dhe 61% prej tyre kanë thënë që po, dhe që burimi i informacionit ka qenë familja, dhe pak nga profesorët. Kjo gjetje evidentohet edhe në studimin e Institutit Riinvest, ku thuhet se dy të tretat e studentëve marrin udhëzime për karrierë nga familja.[10]

FIGURA 5.

Informimi rreth programit Banka, Financa, dhe Kontabilitet para fillimit të studimeve



10 "Employment and Labour Market Analysis", Instituti Riinvest, 2021, fq. 102, linku: https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2021/October/05/Employment-and-Labour-Market-Analysis-ENG1633434888.pdf

Kur janë pyetur studentët sa mendojnë se është arritur synimi që ata të: "Reflektojnë mbi praktikat e punës, kornizat konceptuale dhe reagimet e performancës dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional të veprimeve", 53% janë përgjigjur se ky qëllim nuk është arritur fare ose është arritur pjesërisht.

Përfaqësuesi i njërës nga bankat e intervistuar e mbështetë këtë konstatim duke thënë se:

> *"Nuk ka ndodhë ende që prej Kosovës të vijnë studentë që i njohin 3-4 elemente bazike me të cilat operojnë bankat, ndërkaq prej shteteve të tjera kur vijnë ka."*

Në bazë të anketimit të studentëve dhe konstatimit të përfaqësuesit të bankës kuptohet se qëllimet e programit në fjalë për sa i përket punës praktike apo të kuptuarit e saj nuk janë arritur. Miti se në universitete publike studentët të paktën përgatiten teorikisht del i pasaktë.

Kur janë pyetur studentët sa mendojnë se është arritur synimi që ata të: "Zhvillojnë kompetencat metodologjike të nevojshme për të kuptuar në mënyrë adekuate gjetjet e reja shkencore në ekonomi, të realizojnë hulumtime dhe të vazhdojë tutje studimet në programin Master.", 52% janë përgjigjur se ky qëllim nuk është arritur fare ose është arritur pjesërisht. Përfaqësuesi i bankës, i intervistuar për qëllimi të këtij studimit e mbështetë këtë gjetje të anketës:

> "Nuk dinë të diskutojnë për ekonomi, se si bankat ndikojnë në ekonomi, shoqëri, përgjegjësi të korporatave. Studentët tek pas disa viteve i kuptojnë këto aftësi. Me Fakultet Ekonomik kur janë nuk dinë. Nuk dinë a janë asete apo detyrime, kursimet për bankën. Nuk kanë aftësi për zgjidhjen e problemeve analitike, komunikim, etj."

Pritshmëritë e studentëve të drejtimit Banka, Financa dhe Kontabilitet për punësimin pas përfundimit të programit janë që të punësohen në fushën e tyre të studimit, pra si kontabilist ose në bankë, dhe një pjesë janë përgjigjur që duan të vazhdojnë një karrierë më akademike duke vazhduar shkollimin mëtutjeshëm

Nga sa shihet me lart mund të konstatohet se në këtë program diskrepanca mes opinioneve të palëve të përfshira lidhur me përshtatshmërinë e aftësive që merren nga programi i studiuar me nevojat e tregut të punës, është e madhe dhe si rrjedhojë ndërhyrjet radikale janë të domosdoshme.

Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike – Programi Inxhinieri Kompjuterike

Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike pretendon se nevoja për të hapur një program të ri bazohet në kërkesat e tregut. Hapja ose vazhdimi i programeve nuk varet nga numri i orëve për profesorë, por në kërkesën e tregut dhe të studentëve për atë program. Që nga 2014 nuk ka pasur programe të reja, por vetëm përditësim të programeve aktuale.

Në pyetjen se a vazhdohen programet vetëm për të plotësuar normën e orëve të profesorëve, menaxhmenti thotë që në fakt ata kanë mungesë të stafit.

Gjatë hartimit të programit, profesorët dhe menaxhmenti i Inxhinierisë Kompjuterike supozohen të përfshijnë nevojat e tregut të punës në mënyrë që të marrin akreditimin e atij programi. Para se të hapet një program, pritet të konsultohet Bordi Industrial.


Asnjëra nga kompanitë e intervistuara nuk është e përfshirë në Bordin Industrial të FIEK, dhe nuk është ftuar ndonjëherë formalisht.

> "Nuk jemi ftuar për konsultim, as si kompani e as personalisht. Ka 5 vite që kompania jonë është funksionale."— PËRFAQËSUESI I KOMPANISË SË INXHINIERISË KOMPJUTERIKE

Në anën tjetër, studentët vitit të tretë janë pyetur nëse janë informuar paraprakisht nga dikush për programin dhe aftësitë që do t'i marrin pas përfundimit të studimeve, dhe 39% kanë thënë që po, dhe që burimi i informacionit ka qenë familja, studentët e mëhershëm të programit dhe vetëm një është informuar nga syllabuset në uebfaqe.

FIGURA 6.

Informimi rreth programit Inxhinieri Kompjuterike para fillimit të studimeve



Kur janë pyetur studentët sa mendojnë se është arritur synimi që ata të: "Analizojnë në mënyrë kritike dhe kreative problemet në Inxhinierisë Kompjuterike dhe Softuerike dhe ofrojnë zgjidhje për të njëjtat përmes përdorimit të teknikave të teknologjisë së informacionit (TI-së).", 65% të tyre mendojnë se ky qëllim është arritur plotësisht dhe gati plotësisht.

Përfaqësuesi i kompanisë, i intervistuar për qëllime të këtij studimi thotë:

> "Studentët në përgjithësi e marrin një bazë, sa i përket teorisë janë të mirë, në matematikë janë të mirë, ne e ndërtojmë mbi ta një profil të kompanisë. Direkt nevojat nuk i përmbushin. Në përgjithësi jemi të kënaqur me ta, ka përputhje, por ka ca teknologji të reja që janë në trendi e që nuk iu përcillen studentëve."

Për sa i përket aftësive praktike duket se programet e ofruara në Inxhinieri Kompjuterike nuk janë të përditësuara në mënyrë adekuate. Këtë konstatim e mbështet menaxhmenti i fakultetit, të cilët thanë se që prej vitit 2014 nuk ka pasur programe të reja por përditësim të programeve aktuale.

> Njëri nga të intervistuarit të kompanisë së IT-së thotë se të diplomuarit e punësuar kanë nevojë për trajnime shtesë: "*Trajnimi zgjatë minimumi 3 deri në 6 muaj, por në shumicën e rasteve 6 muaj dhe kjo bëhet për gjëra kryesisht elementare.*" I intervistuari tjetër konstaton se të diplomuarit e punësuar "*Kanë telashe në komunikim dhe në aftësi të buta, derisa të kyçen në ekip. Studentët nga kolegjet private kanë 'soft skills' shumë më të mira, krijojnë storie e shesin gjithçka, por programerat janë shumë introverta, ka raste edhe që nuk dinë anglisht.*"

Në anën tjetër studentët pajtohen me këtë konstatim të përfaqësuesve të kompanive ku 46% e të anketuarve kanë thënë se nuk e dinë çfarë aftësish kërkohen nga punëdhënësit potencialë.

Mund të konstatohet se në këtë program diskrepanca mes opinioneve të palëve të përfshira lidhur me përshtatshmërinë e aftësive që merren nga programi

i studimit me nevojat e tregut të punës, nuk është e madhe dhe si rrjedhojë lehtë e sanueshme.

Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike – Programi Elektroenergjetikë

Profesorët dhe menaxhmenti i programit të Elektroenergjetikës thonë që programet janë të ndërtuara në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe që planprogramet janë të harmonizuara me standarde ndërkombëtare profesionale.

Gjatë hartimit të programit, profesorët dhe menaxhmenti i Elektroenergjetikës supozohen të përfshijnë nevojat e tregut të punës në mënyrë që të marrin akreditimin e atij programi. Para se të hapet një program, konsultohet Bordi Industrial, nga të cilët marrin komente për lëndë ose programe. Shumë nga profesorët e këtij programi vijnë po ashtu nga industria, dhe kanë mundësinë të japin edhe komentet e industrisë.

Nuk ka matje të kërkesës së tregut të punës për studentët që diplomohen nga elektroenergjetika, por profesorët theksojnë që tregu ka shumë më shumë nevojë se që ka studentë që diplomohen.

Fakti që në Kosovë konsiderohet informacion i mirëqenë publik nevoja për elektro-inxhinierë, mbase deri në një masë mund ta arsyetojë mosftuarjen e kompanive të fushës gjatë hartimit të programeve. Njëri nga të intervistuarit nga ana e kompanive deklaron:

> "Formalisht nuk kemi pasur ndonjë kërkesë për përfshirje. Ne kemi disa punëtorë që punojnë në elektroenergjetikë dhe kanë mundur të kontribuojnë por jo drejtpërdrejtë." - PËRFAQËSUESI I KOMPANISË ELEKTRO-ENERGJETIKE

Syllabuset e programit që në fakt janë shpërfaqjet më të detajuara të tij sipas vet profesorëve të fakultetit janë të kopjuara por të përshtatura sipas vlerësimeve të tyre. Në një formulim interesant, një profesor i intervistuar sqaron këtë proces:

> "...kemi përdorë praktikat më të mira nga vendet evropiane dhe botërore, në lidhje me krijimin e syllabuseve mirëpo gjithmonë duke pasur parasysh që ky proces nuk ka shku vetëm copy dhe paste. Por gjithmonë ky proces shkon në atë formatin që bëhet copy pastaj bëhet edit, domethënë njëherë e shikojmë edhe tek në fund bëhet paste. Njëherë duhet ta bëjmë edit këto syllabuse dhe programe t'i përshtatim praktikisht për rrethanat tona, për kërkesat për tregun vendor dhe ndërkombëtar, dhe pastaj e bëjmë paste." – PROFESOR NË ELEKTROENERGJETIKË.

Në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, ka kohë që nuk është hapur një program i ri, por vetëm vazhdohen akreditimet e programeve ekzistuese.

Syllabuset e programit sipas profesorëve dhe menaxhmentit të fakultetit ndërtohen nga profesorët e lëndëve përkatëse, mbi standardet ndërkombëtare. Profesorët nga FIEK thonë që ndjekin rekomandimet e IEEE (Institute of Electrical and Electronics Engineers) se si duhet të ndërtohet një program studimi. Po ashtu, planprogramet zakonisht adaptohen nga universitete të Vjenës, Zagrebit dhe Lubjanës.

Pavarësisht pohimit të profesorëve të fakultetit se syllabuset e programeve janë në përputhje me standardet ndërkombëtare, punëdhënësit potencialë theksojnë mungesën e aftësive praktike të studentëve dhe njohurive praktike të makinerisë dhe mjeteve të punës.

> "Në aspektin e teorisë janë të përgaditur mirë, por kanë vështirësi me i apliku në botën reale. Janë të përgaditur mirë në përdorim të teknologjisë dhe gjuhëve të huaja, por kanë telashe me njohje të pajisjeve." – PËRFAQËSUESI I KOMPANISË ELEKTRO-ENERGJETIKE

Ndërkaq edhe studentët janë të vetëdijshëm që u mungojnë disa aftësi praktike për tregun e punës. Gjatë anketimit kur u është kërkuar të vlerësojnë se sa është arritur qëllimi "Të diplomuarit do analizojnë dhe specifikojnë pajisjet për monitorim, kontroll dhe mbrojtje të sistemit elektroenergjetik.", 26% kanë thënë


se ky qëllim nuk është arritur fare ose është arritur pjesërisht, ndërkaq 32% mendojnë se ky qëllim është arritur deri në gjysmë.

Studentët e vitit të tretë po ashtu janë pyetur nëse janë informuar paraprakisht nga dikush për programin dhe aftësitë që do i marrin pas përfundimit të studimeve, dhe 73% kanë thënë që po, dhe që burimi i informacionit ka qenë familja, studentët e mëhershëm të programit dhe nga stafi akademik.

Nga sa u tha më lartë mund të konstatohet se në këtë program diskrepanca mes opinioneve të palëve të përfshira lidhur me përshtatshmërinë e aftësive që merren nga programi i studiuar me nevojat e tregut të punës, nuk është e madhe dhe si rrjedhojë lehtë e sanueshme. Madje kjo diskrepancë është më e vogël sesa në programin e Inxhinierisë Kompjuterike brenda të njëjtit fakultet.

FIGURA 7.

Informimi rreth programit Elektroenergjetikë para fillimit të studimeve



Fakulteti i Filologjisë – Programi Gazetari

Në Fakultetin e Filologjisë, zhvillimi dhe aprovimi i programeve të reja studimore bëhet në pajtim me standardet e caktuara nga Komisioni i studimeve, nga Këshilli i fakultetit, Zyra për Zhvillim Akademik dhe nga Zyra për Cilësi në nivel qendror të UP-së. Sipas menaxhmentit, merren parasysh kërkesat e tregut, rekomandimet e Trupës Këshillëdhënëse dhe standardet e hapësirës evropiane të arsimit të lartë, si dhe komentet e të diplomuarve dhe rekomandimet e ekspertëve nga procedurat e akreditimit të programeve të përafërta.

Gjatë hartimit të programit, profesorët dhe menaxhmenti supozohen të përfshijnë nevojat e tregut të punës në mënyrë që të marrin akreditimin e atij programi. Para se të hapet një program, konsultohet Trupi Këshillëdhënës[11].

Ndërkaq, asnjëra nga kompanitë e intervistuara nuk është konsultuar nga universiteti ose Fakulteti i Filologjisë në përpilimin e programit të gazetarisë.

> "Zyrtarisht jo. Ka komunikim shumë të limituar me stafin akadamik të programit."
> – PËRFAQËSUES I KOMPANISË MEDIALE

Sipas menaxhmentit të Fakultetit të Filologjisë, nuk ndodhë që të hapet programi i ri studimor në varësi të numrit të orëve të profesorëve. Të dhënat për tregun e punës ky fakultet i merr nga anëtarët e Trupës Këshillëdhënëse dhe nga të diplomuarit e fakultetit.

Ndonëse nuk dihet se çfarë është përbërja e kësaj trupe apo cila është metodologjia për mbledhjen e këtyre informacioneve për qëllime të këtij studimi deri në këtë pikë, pretendimi do të merret i mirëqenë.

Profesorët theksojnë që nuk ka të dhëna të mjaftueshme për nevojat e tregut apo trendet e rritjes ose rënies në industri të caktuara, por i llogarisin në bazë të ngopjes së tregut.

> "Programi bëhet në raport me një përllogaritje të nevojave të tregut, dhe programi i gazetarisë për shembull para nja 5-6 vjetve ka pasë 250 studentë, pastaj kemi pa që tregu ka fillu me u ngop dhe është ulë numri, dhe tash pranohen 120 studentë." – PROFESOR NË GAZETARI.

Të tre kompanitë e intervistuara mediatike pajtohen se shpërputhja mes aftësive të fituara të studentëve të diplomuar dhe nevojave të tregut mediatik në Kosovë është diametrale.

Një nga të intervistuarit thotë:

> "Studentët dallojnë individualisht. Dituri praktike mbi gazetarinë nuk ka. Disa forma se si bëhet gazetaria nuk i dinë. Kur studentët vijnë prej një mësimi shumë teorik, nuk e kanë fleksibilitetin dhe kreativitetin për mënyrën se si shkojnë gjërat në gazetari. Gazetaria evoluon, programi i studimeve nuk evoluon aq shpesh. Në program mësohet për gazeta të shtypura, por në Kosovë nuk ka më shtyp. Mësojnë për faqosjen që nuk nevojitet më."
> - PËRFAQËSUES I KOMPANISË MEDIALE

Ngjashëm shprehet edhe i intervistuari nga kompani tjetër:

> "Ne marrim studenta, janë nën mesatare për TV, ndërsa për gazetë online janë më të përgaditur edhe pse shpesh mendojnë që duhet shkruar si për gazetë dhe se teksti në TV e në gazetë online duhet të jetë i vogël. Nuk e dinë që në tekstin për TV, mënyrat e deklaratës dallojnë (me shkrim, me telefon, me intervistë). Aspektin vizuel nuk dinë ta realizojnë; teknikën, xhirimi (bashkëpunimi me kameramanë), montimi, leximi – të gjitha çalojnë. Strukturën e lajmit e kanë të përzier me atë që praktikohet në gazeta, ndonëse nuk ka më gazetë të shtypur në Kosovë." -
> PËRFAQËSUES I KOMPANISË MEDIALE

11 Trupa këshillëdhënëse apo bordi industrial parashihen të jenë pjesë e çdo fakulteti dhe kryejnë funksionin e njëjtë

Studentët e këtij programi duhet të jenë më kritik në vlerësimin e arritjes së qëllimeve të programit. Më shumë se katër nga pesë studentë (86%) mendojnë se qëllimi i programit për të fituar "njohuri dhe shkathtësi për radiogazetari" është arritur gati plotësisht apo plotësisht. Asnjë prej tyre nuk mendon se ky qëllim është arritur pjesërisht apo që nuk është arritur fare.

Situata vazhdon të jetë shqetësuese kur të anketuarit janë pyetur nëse qëllimi i programit për të fituar "njohuri dhe shkathtësi për gazetarinë e televizionit", 85% mendojnë se qëllimi është arritur gati plotësisht apo plotësisht. Sërish asnjë nga të anketuarit nuk ka menduar se ky qëllim nuk është arritur fare apo është arritur pjesërisht.


Konfuz shfaqet edhe stafi akademik. Një nga të intervistuarit shprehet se studenti përgjatë studimeve

> *"ndërton shkathtësi të gjykimit kritik të përmbajtjeve mediale, zhvillon shkathtësi të komunikimit publik, zhvillon shkathtësi të krijimit të fushatave të marrëdhënieve me publikun, fiton shkathtësi të prodhimit të përmbajtjeve për televizionin dhe radion".*

Studentët po ashtu janë pyetur nëse janë informuar paraprakisht nga dikush për programin dhe aftësitë që do i marrin pas përfundimit të studimeve, dhe 55% kanë thënë që po, dhe që sipas tyre burimi kryesor i informacionit kanë qenë stafi akademik i programit, dhe shoqëria që ka studiuar më herët në këtë program.

FIGURA 8.

Informimi rreth programit Gazetari para fillimit të studimeve



Nga sa shihet me lart mund të konstatohet se në këtë program diskrepanca mes opinioneve të palëve të përfshira lidhur me përshtatshmërinë e aftësive që merren nga programi i studiuar me nevojat e tregut të punës, është e madhe dhe si rrjedhojë ndërhyrjet radikale janë të domosdoshme. Ajo çka mbetet edhe më shqetësuese në këtë program krahasuar me Banka, Financa dhe Kontabilitet është mungesa e të menduarit kritik të studentëve respondent në anketë, ku në një sërë pyetjesh të anketës numri i atyre që kanë menduar se qëllime të caktuara të programit nuk janë arritur fare apo janë arritur pjesërisht, është zero (tabela 4).[12]

SECILI ME TË VETEN - PYETËSORI ZBULON SHPËRPUTHJEN MES PRITSHMËRIVE TË STUDENTËVE DHE ASAJ QË OFROHET NË UNIVERSITET

Studentët e vitit të parë nga katër programet e studimit, janë anketuar për arsyet mbrapa zgjedhjes së tyre për programin e studimeve, njohuritë e tyre paraprake për programin, si dhe për pritjet e tyre nga programi dhe çka ata presin të punojnë pas përfundimit të studimeve.

Studentët e vitit të fundit nga katër programet e studimit, janë anketuar për arsyet mbrapa zgjedhjes së tyre për programin e studimeve, për pritjet e tyre nga programi dhe çka ata presin të punojnë pas përfundimit të studimeve.

Krahasuar me pjesët e mësipërme, apo me hartën e pyetjeve për hisedarët (kryesisht kompanitë) vërehet më në detaje shpërputhja mes asaj se çfarë presin studentët të zotërojnë si aftësi pasi t'i kenë përfunduar me sukses studimet e tyre, me atë që ofrohet në universitet. Optimizmi i studentëve dhe entuziazmi i tyre për të ndërtuar pritje të pabazuara në ndonjë lloj të informimit formal nga ana e ndonjë institucioni relevant, mbetet temë për studime të mëtejshme.

Fakulteti Ekonomik – Programi Banka, Financa dhe Kontabilitet

Janë anketuar 20 studentë të vitit të parë nga drejtimi Banka, Financa, dhe Kontabilitet. Në pyetjen se pse kanë zgjedhur këtë program studimi, këta studentë janë përgjigjur me disa ide kryesore, që përfshijnë nevojën e tregut për këtë profesion, dëshirën e tyre për të punuar në këtë sektor, si dhe për shkak se kishin njohuri paraprake të këtij drejtimi që donin t'i forconin.

Në pyetjen se çka presin të mësojnë specifikisht nga programi, studentët janë përgjigjur se, mes tjerash, duan të mësojnë për punën në banka, në kontabilitet, aftësitë menaxhuese, përdorimi i statistikave, të jenë në gjendje të kryejnë analiza financiare.

Studentët po ashtu janë pyetur nëse janë informuar paraprakisht nga dikush për programin dhe aftësitë që do i marrin pas përfundimit të studimeve, dhe 50% e tyre kanë thënë që po, dhe që burimi i informacionit ka qenë familja. Mungesa e udhëzimit të karrierës dhe ditëve të hapura në universitete për informimin e duhur të nxënësve para fillimit të studimeve, mund të kontribuojë në përzgjedhje të gabuar dhe painformuar për studim.

36 studentë të vitit të fundit janë anketuar nga programi Banka, Financa, dhe Kontablitet. Në pyetjen se pse kanë zgjedhur këtë program studimi, mes tjerash, këta studentë kanë thënë që ju ka pëlqyer dhe interesuar, ka kërkesë në treg të punës.

Në vijim janë të paraqitur përqindjet e studentëve të anketuar sipas pajtueshmërisë së tyre me arritjen e rezultatit të të nxënit.

12 Shih fq. 32 "Fakulteti i Filologjisë – Programi Gazetari".

TABELA 1.

Përgjigjet e studentëve të programit Banka, Financa, dhe Kontabilitet, se sa pajtohen që janë arritur rezultatet e të nxënit të programit


	1 nuk është arritur fare	2 është arritur pjesërisht	3 është arritur deri në gjysmë	4 është arritur gati plotësisht	5 është arritur plotësisht
"Demonstrojnë njohuri të gjera dhe koherente të disiplinave teorike dhe profesionale të bankave, financave, analizave të investimeve, menaxhimit të portofolit, kontabilitetit, ekonomisë, metodave sasiore, ligjit dhe Industrisë së Shërbimeve Financiare, etj." Sa mendoni se është arritur ky synim?	6%	22%	39%	31%	3%
"Ushtrojnë gjykim adekuat në një mjedis profesional i cili thekson vendimmarrjen etike dhe të përgjegjshme." Sa mendoni se është arritur ky synim?	6%	33%	19%	25%	17%
"Zhvillojnë kapacitet për të integruar njohuritë teknike dhe konceptuale, dhe aftësitë ndërpersonale për të punuar efektivisht në kuadër të Industrisë së Shërbimeve Financiare dhe Bankare." Sa mendoni se është arritur ky synim?	11%	28%	36%	19%	6%
"Fitojnë dhe sintetizoni informacionin brenda një mjedisi kompleks profesional." Sa mendoni se është arritur ky synim?	8%	31%	39%	14%	8%
"Mendoni në mënyrë kritike dhe kreative për të identifikuar zgjidhje më të mira brenda kufizimeve të biznesit." Sa mendoni se është arritur ky synim?	11%	17%	17%	39%	17%
"Punojnë në bashkëpunim me të tjerët për të zgjidhur problemet e aplikuara." Sa mendoni se është arritur ky synim?	6%	17%	31%	25%	22%
"Komunikojnë dhe shpjegoni këshilla të specializuara teknike, njohuri dhe ide, për profesionistët dhe jo-ekspertë të përfshirë në industrinë e shërbimeve financiare." Sa mendoni se është arritur ky synim?	11%	31%	28%	14%	17%
"Reflektojnë mbi praktikat e punës, kornizat konceptuale dhe reagimet e performancës dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional të veprimeve" Sa mendoni se është arritur ky synim?	22%	31%	22%	19%	6%
"Zhvillojnë kompetencat metodologjike të nevojshme për të kuptuar në mënyrë adekuate gjetjet e reja shkencore në ekonomi, të realizojnë hulumtime dhe të vazhdojë tutje studimet në programin Master." Sa mendoni se është arritur ky synim?	19%	33%	25%	14%	8%

Përqindja e ulët në dy skajet e tabelës (nuk është arritur fare apo është arritur plotësisht) mund të jetë tregues se studentët e këtij programi as nuk duan të keqparaqesin vetveten para një studimi mbi aftësitë e tyre të fituara në program, as nuk mund të deklarohen se janë të përgatitur mjaftueshëm për tregun e punës.

Studentët janë pyetur për sfida të ndryshme që mund t'i pengojnë ata në arritjen e qëllimeve të tyre në karrierë. Aty kanë thënë që mund të përpilojnë CV dhe letër motivimi pa problem, por që nuk kanë njohuri të mjaftueshme se çka kërkojnë punëdhënësit.

FIGURA 9.

Sfidat e studentëve të programit Banka, Financa, dhe Kontabilitet në arritjen e qëllimeve të tyre në karrierë




Burimi: të dhënat e anketës, ORCA (2021)

Mospërputhja mes perceptimit të studentëve dhe deklarimeve të kompanive mbi aftësitë e studentëve, bëhet edhe më evidente përmes tabelës më lartë (tabela 1) dhe deklarimeve mbi pritshmëritë për punësim në fushën e tyre. Mbi një e treta e studentëve (37%) të këtij programi mendojnë se e dinë saktësisht çfarë synojnë dhe se pritshmëritë e tyre janë që pas përfundimit të programit të punësohen në fushën e tyre të studimit, pra si kontabilistë ose në bankë. Mirëpo, në anën tjetër kompanitë e intervistuara kanë thënë se shumica e studentëve nuk i njohin konceptet bazë që nevojitën për këto fusha.

Studentët po ashtu janë pyetur për nevojat e tyre për përmirësim para se të hyjnë në tregun e punës. Këtu përfshijnë nevojën për të mësuar qysh hapet një biznes privat, si të mësojnë aftësitë e nevojshme për punë dhe të mësojnë për mundësitë ekzistuese të punësimit (Figura 10).

FIGURA 10.

Nevojat e studentëve të programit Banka, Financa, dhe Kontabilitet për përmirësim para hyrjes në treg të punës



Burimi: të dhënat e anketës, ORCA (2021)

Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike – Programi Inxhinieri Kompjuterike

24 studentë të vitit të parë janë anketuar nga programi i Inxhinierisë Kompjuterike. Arsyet kryesore pse studentët e inxhinierisë kompjuterike kanë zgjedhur këtë program, sipas tyre, janë kryesisht nga pëlqimi për fushë, si dhe mundësitë e punësimit në treg të punës pas përfundimit të studimeve.

Në pyetjen se çka presin të mësojnë specifikisht nga programi, studentët janë përgjigjur se, mes tjerash, duan të mësojnë programim, analizim, dizajn dhe krijim i pjesëve harduerike dhe softuerike të kompjuterëve.

Studentët po ashtu janë pyetur nëse janë informuar paraprakisht nga dikush për programin dhe aftësitë që do i marrin pas përfundimit të studimeve, dhe shumë prej tyre (71%) kanë thënë që po, dhe që burimi kryesor i informacionit kanë qenë studentët e mëhershëm të programit (familjarë, shoqëri).

28 studentë të vitit të fundit janë anketuar nga programi i Inxhinierisë Kompjuterike. Në pyetjen se pse kanë zgjedhur këtë program studimi, mes tjerash, këta studentë kanë thënë që ju ka pëlqyer dhe interesuar, ka kërkesë në treg të punës, ka të ardhura të larta, kanë qenë të aftë në lëndët bazë të këtij programi paraprakisht. Në vijim janë të paraqitur përqindjet e studentëve të anketuar sipas pajtueshmërisë së tyre me arritjen e rezultatit të të nxënit.

TABELA 2.

Përgjigjet e studentëve të programit Inxhinieri Kompjuterike se sa pajtohen që janë arritur rezultatet e të nxënit të programit

	1 nuk është arritur fare	2 është arritur pjesërisht	3 është arritur deri në gjysmë	4 është arritur gati plotësisht	5 është arritur plotësisht
"Analizojnë në mënyrë kritike dhe kreative problemet në Inxhinierisë Kompjuterike dhe Softuerike dhe ofrojnë zgjidhje për të njëjtat përmes përdorimit të teknikave të teknologjisë së informacionit (TI-së)." Sa mendoni se është arritur ky synim?	3%	11%	21%	54%	11%
"Ndërmarrin një qasje hulumtuese ndaj zgjidhjeve që duhet të ofrohen përmes përdorimit të TI--së." Sa mendoni se është arritur ky synim?	3%	11%	25%	50%	11%
"Njohin problemet dhe principet themelore të veglave të ndryshme që përdoren në lëmin e TI-së" Sa mendoni se është arritur ky synim?	11%	7%	25%	36%	21%
"Demonstron një nivel të avancuar të njohurive shkencore nga fusha e Inxhinierisë Kompjuterike dhe Softuerike dhe fusha e tyre e zgjedhur (specializimi)" Sa mendoni se është arritur ky synim?	11%	7%	46%	29%	7%
"Demonstron origjinalitet në aplikimin e njohurive të fituara dhe të kuptuarit praktik për gjetjen dhe zgjidhjen e problemeve dhe vepron në mënyrë të pavarur në planifikimin dhe implementimin e hulumtimit" Sa mendoni se është arritur ky synim?	7%	14%	25%	32%	22%
"Analizon në mënyrë kritike teoritë shkencore, modelet, konceptet dhe teknikat nga fusha e përzgjedhur." Sa mendoni se është arritur ky synim?	0%	11%	43%	36%	10%
"Lexon në mënyrë kritike dhe vlerëson rezultatet e hulumtimit kualitativ dhe kuantitativ nga fusha e zgjedhur." Sa mendoni se është arritur ky synim?	7%	11%	32%	32%	18%
"Komunikon në mënyrë efikase dhe bindëse, në formë gojore dhe të shkruar" Sa mendoni se është arritur ky synim?	7%	21%	18%	36%	18%
"Përpilon projekte për zgjidhjen e problemeve në fushata e ndryshme të Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike" Sa mendoni se është arritur ky synim?	7%	18%	14%	39%	22%
"Ofron këshilla dhe ekspertizë në lëmin e Inxhinierisë Kompjuterike dhe Softuerike" Sa mendoni se është arritur ky synim?	11%	14%	28%	29%	18%

	1 nuk është arritur fare	2 është arritur pjesërisht	3 është arritur deri në gjysmë	4 është arritur gati plotësisht	5 është arritur plotësisht
"Analizon kërkesat e TI-së duke marrë parasysh nevojat e konsumatorëve dhe zbatoj këto kërkesa në një mënyrë praktike" Sa mendoni se është arritur ky synim?	21%	14%	32%	22%	11%
"Analizon, modelon, abstrahon dhe zbaton aspekte afariste dhe teknike në rrjedhën e projekteve të TI-së" Sa mendoni se është arritur ky synim?	11%	21%	32%	25%	11%
"Njihet shumë shpejt me tema të specializuara për të kuptuar ndërlidhjet teknike komplekse në mjedisin e biznesit" Sa mendoni se është arritur ky synim?	14%	18%	39%	18%	11%
"Zbulon metoda për të mbështetur strategjinë në vendet ku punësohen dhe nevojat për përpunimin e informacionit në mënyrë që të optimizoni proceset komplekse përmes përdorimit të teknologjisë më të fundit të informacionit" Sa mendoni se është arritur ky synim?	14%	14%	40%	25%	7%
"Analizon dhe projekton sisteme softuerike si dhe skenarët e tyre të ndërveprimit" Sa mendoni se është arritur ky synim?	11%	11%	18%	46%	14%
"Identifikon, diskuton dhe zgjidh konfliktet potenciale dhe keqkuptimet e mundshme midis biznesit dhe teknologjisë si në nivel teknik dhe ndërpersonal dhe marrjen e masave parandaluese" Sa mendoni se është arritur ky synim?	11%	14%	32%	32%	11%
"Komunikon me profesionistët teknikë dhe jo teknikë, paraqet informacionin teknik në një mënyrë që është gjithashtu e kuptueshme për personelin jo-teknik dhe kontribuon në mënyrë konstruktive për të siguruar bashkëpunim pozitiv brenda ekipeve" Sa mendoni se është arritur ky synim?	7%	14%	25%	47%	7%
"Zbaton qasjen ndërdisiplinore në hartimin e sistemeve të TI-së" Sa mendoni se është arritur ky synim?	4%	11%	36%	28%	21%


Burimi: të dhënat e anketës, ORCA (2021)

Me përqindje të larta të koncentruar në kolonën e parafundit (është arritur gati plotësisht) studentët e programit Inxhinieri Kompjuterike shfaqen optimistë për arritjet specifike të qëllimit të programit të tyre të studimeve. Kompanitë e intervistuara të kësaj fushe e kanë konfirmuar deri në një masë faktin se studentët e këtij programi janë të përgatitur.

Studentët po ashtu janë pyetur për sfida të ndryshme që mund t'i pengojnë ata në arritjen e qëllimeve të tyre në karrierë. Aty kanë thënë që mund të përpilojnë CV dhe letër motivimi pa problem, por që disa nuk kanë njohuri të mjaftueshme se qysh kërkohet një punë, ose çka synojnë të bëjnë.

FIGURA 11.

Sfidat e studentëve të programit Inxhinieri Kompjuterike në arritjen e qëllimeve të tyre në karrierë




Burimi: të dhënat e anketës, ORCA (2021)

Një kompani e intervistuar e fushës së kompjuterikes përgënjeshtron deklarimet e studentëve mbi aftësitë e buta që ata i zotërojnë. Përfaqësuesi i kësaj kompanie ka thënë se: *"Studenti duhet të ketë potencialin të mësojë por duhet të ketë edhe aftësi të buta, të cilat nuk i kanë në nivelin e duhur."* Gjithsesi kjo mund të sanohet lehtësisht meqë kompanitë në përgjithësi kanë deklaruar se studentët e kanë një bazë të mirë të përgatitjes profesionale dhe se për mungesën e mundshme të aftësive ata sigurojnë trajnime shtesë për të punësuarit e tyre në këtë fushë.

Studentët po ashtu janë pyetur për nevojat e tyre për përmirësim para se të hyjnë në tregun e punës. Këtu, mes tjerash, përfshihet nevoja për të mësuar si hapet një biznes privat, si të mësojnë të marrin vendime për karrierë.

FIGURA 12.

Nevojat e studentëve të programit Inxhinieri Kompjuterike për përmirësim para hyrjes në treg të punës



Burimi: të dhënat e anketës, ORCA (2021)

Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike – Programi Elektroenergjetikë

13 studentë të vitit të parë janë anketuar nga programi i Elektroenergjetikës. Arsyet kryesore pse studentët e e këtij drejtimi kanë zgjedhur këtë program, sipas tyre, janë kryesisht për punësim, për shkak të nevojës në treg për inxhinierë, dhe për shkak të dëshirës së tyre për të studiuar këtë fushë.

Në pyetjen se çka presin të mësojnë specifikisht nga programi, studentët janë përgjigjur se, mes tjerash, duan të mësojnë më shumë për elektricitetin, rrjetat dhe pajisjet elektrike, si shpërndahet energjia elektrike, instalimet elektrike, si përfitohet energjia elektrike nga burimet e ripërtëritshme, si të zgjidhen problemet inxhinierike.

Studentët po ashtu janë pyetur nëse janë informuar paraprakisht nga dikush për programin dhe aftësitë që do i marrin pas përfundimit të studimeve, dhe vetëm 30% e tyre kanë thënë që po, dhe që burimi kryesor i informacionit ka qenë familja dhe interneti.

Profesorët mendojnë që studentët janë të informuar deri në një masë por jo plotësisht. Një pjesë e studentëve po ashtu nuk kanë njohuri për konceptet teorike të fushës.

> "Kënaqshëm kanë, por ka edhe të tjerë, një numër i vogël që e kanë huqë, apo që kanë informatë jo të saktë se ata mendojnë që këtu prodhohet rryma." – PROFESOR NË ELEKTROENERGJETIKË.

Pritshmëritë e studentëve të Elektroenergjetikës për punësimin pas përfundimit të programit janë që, mes tjerash, të punësohen në fushën e tyre të studimit, pra si inxhinier elektrik, ose të kenë kompani të instalimeve elektrike.

Studentët e vitit të fundit nga katër programet e studimit, janë anketuar për arsyet mbrapa zgjedhjes së tyre për programin e studimeve, për pritjet e tyre nga programi dhe çka ata presin të punojnë pas përfundimit të studimeve.

Në vijim janë të paraqitur përqindjet e studentëve të anketuar sipas pajtueshmërisë së tyre me arritjen e rezultatit të të nxënit.

TABELA 3.

Përgjigjet e studentëve të programit Elekroenergjetikë se sa pajtohen që janë arritur rezultatet e të nxënit të programit

	1 nuk është arritur fare	2 është arritur pjesërisht	3 është arritur deri në gjysmë	4 është arritur gati plotësisht	5 është arritur plotësisht
"Përgatitë studentë për karrierë profesionale dhe studime të mëtejme në fushën e inxhinierisë elektrike, lëminë e elektroenergjetikës." Sa mendoni se është arritur ky synim?	5%	21%	32%	32%	10%
"Të diplomuarit duhet të jenë kompetent të kuptojnë punën e sistemit elektroenergjetikë kompleks." Sa mendoni se është arritur ky synim?	10%	16%	26%	32%	16%
"Të diplomuarit do të fitojnë njohje më të thelluara të gjenerimit, transmisionit, shpërndarjes dhe shfrytëzimit të energjisë elektrike." Sa mendoni se është arritur ky synim?	5%	11%	37%	21%	26%
"Të diplomuarit do të jenë në gjendje të specifikojnë pajisjet për monitorim, kontroll dhe mbrojtje të sistemeve elektroenergjetike." Sa mendoni se është arritur ky synim?	0%	26%	42%	16%	16%
"Të diplomuarit do të janë në gjendje të vlerësojnë dhe identifikojnë faktorët që ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe stabilitetin e sistemit elektroenergjetik." Sa mendoni se është arritur ky synim?	5%	5%	37%	37%	16%

	1 nuk është arritur fare	2 është arritur pjesërisht	3 është arritur deri në gjysmë	4 është arritur gati plotësisht	5 është arritur plotësisht
"Të diplomuarit do të janë në gjendje të përpilojnë planifikimin dhe projektimin e rrjeteve transmisionit, rrjeteve shpërndarëse dhe stabilimenteve elektroenergjetike." Sa mendoni se është arritur ky synim?	21%	16%	32%	21%	10%
"Të diplomuarit do aplikojnë njohuri të matematikës dhe inxhinierisë në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme në operimin e sistemit elektroenergjetik." Sa mendoni se është arritur ky synim?	0%	16%	16%	47%	21%
"Të diplomuarit do analizojnë dhe specifikojnë pajisjet për monitorim, kontroll dhe mbrojtje të sistemit elektroenergjetik." Sa mendoni se është arritur ky synim?	5%	21%	32%	26%	16%
"Të diplomuarit do identifikojnë, formulojnë dhe zgjidhin probleme në fushën e: projektimit, operimit dhe menaxhimit të gjenerimit, rrjeteve të transmisionit, rrjeteve të shpërndarjes, si dhe shfrytëzimit të energjisë elektrike." Sa mendoni se është arritur ky synim?	5%	26%	16%	42%	11%
"do nxitet dhe zhvillohet mendimi kritik, qasja profesionale, në zgjidhjen e çështje në lëmin e elektroenergjetikës." Sa mendoni se është arritur ky synim?	0%	16%	42%	21%	21%


Burimi: të dhënat e anketës, ORCA (2021)

Siç e kemi përmendur në kapitullin e kaluar për të njëjtin program, nga ballafaqimi i palëve (menaxhment i fakultetit, profesorë, studentë, kompani) vërehet se diskrepanca mes aftësive të fituara dhe nevojave të tregut të punës nuk është aq e madhe në këtë fushë studimi. Andaj, edhe deklarimet e studentëve për arritjet e qëllimeve të programit janë kryesisht afirmative. Krahasuar me përgjigjet e studentëve të programit Banka, Financa, dhe Kontabilitet, vërehet se studentët e këtij programi ndihen më të lirë për të shprehë mendimet e tyre kritike karshi programit.

Studentët janë pyetur për sfida të ndryshme që mund t'i pengojnë ata në arritjen e qëllimeve të tyre në karrierë. Aty kanë thënë që mund të përpilojnë CV dhe letër motivimi pa problem, por që disa nuk kanë njohuri të mjaftueshme se çka synojnë të bëjnë.

FIGURA 13.

Sfidat e studentëve të programit Elektroenergjetikë në arritjen e qëllimeve të tyre në karrierë




Burimi: të dhënat e anketës,

Studentët po ashtu janë pyetur për nevojat e tyre për përmirësim para se të hyjnë në tregun e punës. Këtu përfshijnë nevojën për të mësuar qysh hapet një biznes privat, si të mësojnë aftësitë e nevojshme për punë dhe të mësojnë për mundësitë ekzistuese të punësimit.

FIGURA 14.

Nevojat e studentëve të programit Elektroenergjetikë për përmirësim para hyrjes në treg të punës



Burimi: të dhënat e anketës, ORCA (2021)

Fakulteti i Filologjisë – Programi Gazetari

34 studentë të vitit të parë janë anketuar nga programi i Gazetarisë. Arsyet kryesore pse studentët e gazetarisë kanë zgjedhur këtë program, sipas tyre, janë kryesisht, mes tjerash, nga dëshira për të qenë afër lajmit, për të ngritur zërin për njerëzit e tjerë, për të gjetur të vërtetën, për të ndryshuar mentalitetin e shoqërisë, për të informuar publikun.

Në pyetjen se çka presin të mësojnë specifikisht nga programi, studentët janë përgjigjur se duan të dinë si të jenë gazetarë të mirë, të jenë të aftë të shkruajnë dhe raportojnë lajme, të aftësohen nga profesorët për mendim kritik, të mësojnë për etikën gazetareske, si të debatojnë, të mësojnë si funksionon një medie, dhe të zhvillojnë aftësi teknike për gazetari (video, audio, ueb).

Studentët po ashtu janë pyetur nëse janë informuar paraprakisht nga dikush për programin dhe aftësitë që do i marrin pas përfundimit të studimeve, dhe vetëm 41% e tyre kanë thënë që po, dhe që burimi kryesor i informacionit kanë qenë profesorët e programit.

Pritshmëritë e studentëve të gazetarisë për punësimin pas përfundimit të programit janë që të punësohen në fushën e tyre të studimit, pra si gazetar.

27 studentë të vitit të fundit janë anketuar nga programi i Gazetarisë. Në pyetjen se pse kanë zgjedhur këtë

program studimi, këta studentë kanë thënë që ju ka pëlqyer, për të mësuar gjëra të reja në fusha të ndryshme, të merren me tema të ndryshme përmes shkrimit, ka përfitime të larta, ka kërkesë në tregun e punës, për të informuar publikun me informacione të sakta.

Në vijim janë të paraqitur përqindjet e studentëve të anketuar sipas pajtueshmërisë së tyre me arritjen e rezultatit të të nxënit.

TABELA 4.

Përgjigjet e studentëve të programit Gazetari se sa pajtohen që janë arritur rezultatet e të nxënit të programit

	1 nuk është arritur fare	2 është arritur pjesërisht	3 është arritur deri në gjysmë	4 është arritur gati plotësisht	5 është arritur plotësisht
"Raportimi dhe shkrimi i lajmeve, përmes lëndëve Hyrje në Gazetari dhe Raportim" Sa mendoni se është arritur ky synim?	0%	0%	7%	37%	56%
"Njohuritë themelore për Zhanret e Gazetarisë" Sa mendoni se është arritur ky synim?	0%	0%	0%	26%	74%
"Shkathtësitë e gjuhës përmes lëndës Kulturë Gjuhe" Sa mendoni se është arritur ky synim?	7%	0%	41%	26%	26%
"Njohuritë për Etikën e Medias" Sa mendoni se është arritur ky synim?	0%	0%	4%	26%	70%
"Njohuritë për historinë e gazetarisë shqiptare dhe asaj evropiane" Sa mendoni se është arritur ky synim?	4%	4%	15%	33%	44%
"Mësimi i teorive kryesore të studimit të medias përmes lëndëve Bazat e Komunikimit Masiv" Sa mendoni se është arritur ky synim?	0%	11%	26%	30%	33%
"Njohja e studentëve me literaturën hulumtuese akademike në fushën e komunikimit politik e cila reflekton dhe udhëzon zhvillimin teorik në këtë fushë; studimi dhe aplikimi i teknikave të hulumtimit dhe menaxhimit të komunikimit politik." Sa mendoni se është arritur ky synim?	0%	0%	30%	44%	26%
"Shkathtësitë për Gazetarinë Hulumtuese" Sa mendoni se është arritur ky synim?	4%	0%	11%	41%	44%
"Njohuri dhe shkathtësi për Radiogazetarinë" Sa mendoni se është arritur ky synim?	0%	0%	15%	30%	55%
"Njohuri dhe shkathtësi për Gazetarinë e Televizionit" Sa mendoni se është arritur ky synim?	0%	0%	15%	44%	41%
"Njohuri dhe shkathtësi për Mediat e Reja dhe Portalet" Sa mendoni se është arritur ky synim?	4%	0%	19%	26%	51%

Burimi: të dhënat e anketës, ORCA (2021)


Harmonia mes deklarimeve të profesorëve mbi arritjet e qëllimit të programeve dhe studentëve të cilët e deklarojnë të njëjtën, është tejet shqetësuese kur krahasohet me deklarimet e kompanive mediale të cilat edhe pse të intervistuara pavarësisht njëra-tjetrës, janë konsistent në një gjë: që përgatitja profesionale e studentëve të këtij programi është tejet e dobët.

Përqindjet e larta të koncentruara në anën e djathtë të tabelës (gati plotësisht dhe plotësisht të arritura) tregojnë se palët e përfshira, në veçanti menaxhmenti i këtij programi, duhet të reflektojnë mbi nevojat e përditësuara të gazetarisë, përndryshe qasja në tregun e punës do bëhet edhe më e vështirë se sa mund të jetë aktualisht.

Studentët po ashtu janë pyetur për sfida të ndryshme që mund t'i pengojnë ata në arritjen e qëllimeve të tyre në karrierë. Aty kanë thënë që nuk kanë problem me shkrimin e CV-së ose letrës motivimit, dhe nuk kanë problem në identifikimin e vendit të punës ose aftësive që nevojiten për atë vend të punës.

FIGURA 15.

Sfidat e studentëve të programit Gazetari në arritjen e qëllimeve të tyre në karrierë




Burimi: të dhënat e anketës, ORCA (2021)

Pohimet e njëjta vlejnë edhe për aftësitë e buta, shumica e studentëve kanë deklaruar se kanë arsimimin e duhur apo aftësitë e duhura për me lyp punë, mirëpo realiteti i paraqitur nga kompanitë/mediet e intervistuara paraqitet tërësisht ndryshe. Studentët po ashtu janë pyetur për nevojat e tyre për përmirësim para se të hyjnë në tregun e punës. Këtu disa kanë përmendur nevojën për të mësuar qysh hapet një biznes privat, si të mësojnë aftësitë e nevojshme për punë dhe të mësojnë për marrjen e vendimeve në karrierë.

FIGURA 16.

Nevojat e studentëve të programit Gazetari për përmirësim para hyrjes në treg të punës.



Burimi: të dhënat e anketës, ORCA (2021)

METODOLOGJIA

Ky hulumtim ka për qëllim definimin e hapësirës mes aftësive të fituara të studentëve në programe të universiteteve publike dhe nevojave të tregut të punës në ato fusha të studiuara.

Me këtë qëllim, ORCA ka realizuar anketë me studentë për të kuptuar aftësitë e fituara të tyre në bazë të planprogrameve të studimeve, si dhe pritjet e tyre për tregun e punës.

ORCA gjithashtu ka intervistuar profesorë dhe përfaqësues të menaxhmentit të Universitetit të Prishtinës, për të diskutuar planprogramet që ofrohen dhe zbatohen, si dhe pritjet e tyre për aftësitë e fituara të studentëve nga programet që i ofrojnë ata.

Janë intervistuar dhe përfaqësues të Agjencisë së Kosovës për Akreditim për të diskutuar procesin e vlerësimit të këtyre programeve, dhe pritjet e tyre ndaj programit në aspektin e përmbushjes së nevojave të tregut.

Gjithashtu, janë intervistuar përfaqësues të operatorëve ekonomikë të fushave përkatëse, të cilët punësojnë studentët e diplomuar nga këto fusha, për pritjet që i kanë ata në raport me aftësitë e fituara në studime, nevojat reale që i kanë në ndërmarrjet e tyre, dhe nëse duhen marrë në konsideratë në të ardhmen në përpilimin e planprogrameve.

Për nevoja të këtij hulumtimi janë përzgjedhur katër programe të studimit në Universitetin e Prishtinës:

- Banka, Financa, dhe Kontabilitet;
- Gazetari;
- Elektroenergjetikë;
- Inxhinieri Kompjuterike.

PYETËSORI

Nga secili program janë anketuar rreth 25 studentë, me dallime të vogla mes programeve me më shumë ose më pak studentë respektivisht.

Studentët janë përzgjedhur për anketim në bazë të programit që studiojnë, dhe vitit të studimeve. Një balancë gjinore është synuar, por në disa programe ka pasur më shumë vajza studente. Kritere të tjera përjashtuese nuk janë aplikuar.

Pyetësori për secilin program studimi ka përfshirë pyetje demografike si: mosha, gjinia, viti i studimit, programi, vendi nga vijnë etj.

Studentët e vitit të parë janë anketuar për pritshmëritë e tyre ndaj programit, çka do mësojnë, çka do punojnë në të ardhmen, dhe arsyen pse kanë zgjedhur atë program.

Studentët e vitit të fundit kanë pasur pyetje të hapura për arsyen pse kanë përzgjedhur atë program studimi, dhe çka dëshirojnë të punojnë pas përfundimit të programit. Pastaj, janë prezantuar me 'qëllimin e programit' i listuar në planprogram/raport-vetëvlerësimi për akreditim, dhe studentët kanë vlerësuar nëse ai qëllim është arritur deri në vitin e fundit të programit.

Ata janë prezantuar edhe me rezultatet e pritura të programit dhe/ose lëndëve mësimore, ku janë përgjigjur nëse pajtohen që janë arritur ato rezultate apo jo.

Në total janë anketuar 201 studentë. 91 nga viti i parë i studimeve, dhe 110 nga viti i fundit i studimeve.

TABELA 5.

Të dhënat rreth studentëve të anketuar

	Banka, Financa, dhe Kontabilitet	Elektroenergjetikë	Inxhinieri Kompjuterike	Gazetari	Total
Viti i parë	14 vajza 6 djem	6 vajza 7 djem	15 vajza 9 djem	29 vajza 5 djem	**91 studentë**
	20 total	13 total	24 total	34 total	
	Mosha mesatare 19.2	Mosha mesatare 18.6	Mosha mesatare 18.6	Mosha mesatare 18.7	
Viti i fundit	20 vajza 16 djem	8 vajza 11 djem	13 vajza 15 djem	23 vajza 4 djem	**110 studentë**
	36 total	19 total	28 total	27 total	
	Mosha mesatare 21.8	Mosha mesatare 22.5	Mosha mesatare 21	Mosha mesatare 20.7	

INTERVISTAT

TABELA 6.

Të dhëna rreth të intervistuarve

Profesorë	Menaxhment i Fakultetit	Menaxhment i Universitetit	Agjencia e Kosovës për Akreditim	Kompanitë
3 profesorë nga Banka, Financa, dhe Kontabilitet	1 përfaqësues i dekanatit nga Fakulteti Ekonomik	2 prorektorë	2 përfaqësues nga Agjencia e Kosovës për Akreditim	2 përfaqësues nga bankat
3 profesorë nga Elektroenergjetika	1 përfaqësues i dekanatit nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike			2 përfaqësues nga kompani të fushës së elektroenergjetikës
3 profesorë nga Inxhinieria Kompjuterike	1 përfaqësues i dekanatit nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike			3 përfaqësues nga kompani të fushës së inxhinierisë kompjuterike
3 profesorë nga Gazetaria	1 përfaqësues i dekanatit nga Fakulteti i Filologjisë			3 përfaqësues nga medie

PROFESORË

Intervistat janë realizuar me nga 3 profesorë në secilin program (12 total). Profesorët janë përzgjedhur për intervista nëse janë staf akademik i rregullt i programit, dhe në disa raste nëse janë bartës të programit.

Profesorët janë intervistuar për kurrikulën e programit dhe të lëndëve të tyre specifike. Ata kanë shpjeguar procesin e mendimit të tyre kur përpilojnë syllabuset e tyre, materialet që ata përdorin, dhe literaturën që e ofrojnë. Ata janë përgjigjur për arsyen pse ligjërojnë gjëra të caktuara, nëse e kanë më shumë në konsideratë aspektin teorik apo atë praktik, dhe nëse janë të përditësuar me nevojat e tregut të punës për programin të cilin e ofrojnë.

Ata gjithashtu kanë ofruar mendimin e tyre për aftësitë e fituara nga studentët, dhe nëse ata janë të gatshëm për tregun e punës pas përfundimit të programit.

MENAXHMENTI I UNIVERSITETIT

Dy prorektorë të cilët merren me çështje akademike janë përzgjedhur për intervistë. Prodekanët për çështje akademike ose të studentëve në fakultetet ku përkasin këto katër programe studimi janë përzgjedhur për intervistë.

Intervistat me prodekanët dhe prorektorët e universitetit kanë përfshirë pyetje për procesin e organizimit të mësimit, arsyen e organizimit specifik, dhe arsyet e përfshirjes së lëndëve të caktuara ose rezultateve të pritura për programin në momentin që aplikojnë për akreditim. Ata janë përgjigjur për qëllimin e programit, nëse e kanë paramenduar të jetë më akademik apo t'i përgatisë studentët për tregun e punës, dhe nëse kanë marrë në konsideratë informatat kthyese (feedback) nga kompanitë e fushës specifike.

AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM

Dy përfaqësues nga AKA janë intervistuar për procesin e akreditimit të programeve, çka ata presin nga programet e ofruara, dhe aspektet që ata marrin në konsideratë gjatë akreditimit. Ata gjithashtu kanë treguar nëse ata marrin feedback nga kompanitë e fushave që iu përkasin këto programe studimi. Ata kanë treguar dhe për procesin e vlerësimit të programeve të akredituara, nëse ata marrin vlerësime nga studentët për aftësitë e fituara, apo mënyra tjera të vlerësimit të programit.

KOMPANITË

Kompanitë janë përzgjedhur në mënyrë të qëllimshme si kompanitë më të mëdha në sektoret që korrespondojnë me programet e studimit të këtij raporti.

Nga kompanitë janë intervistuar 2 ose 3 përfaqësues të secilit program studimi të përzgjedhur. Intervistat me përfaqësues kompanish kanë për qëllim kuptimin e procesit të përzgjedhjes së stafit në këto kompani, aftësitë të cilat nevojiten për të kryer punët në atë kompani, dhe nëse kanë pasur përvojë me punësimin e studentëve të po asaj fushe, për të vlerësuar aftësitë e tyre dhe rezultatet e tyre në punë.

Gjithashtu, ata kanë treguar për bashkëpunimin potencial të cilin kanë me universitete apo me Agjencinë e Akreditimit për t'i informuar ata për aftësitë të cilat këta presin nga të diplomuarit e këtyre fushave.



Studentët e vitit të fundit kanë pasur pyetje të hapura për arsyen pse kanë përzgjedhur atë program studimi, dhe çka dëshirojnë të punojnë pas përfundimit të programit. Pastaj, janë prezantuar me ‘rezultatet e programit’ të listuara në planprogram/raport të vetëvlerësimit për akreditim, dhe studentët kanë vlerësuar nëse ato rezultate janë arritur deri në vitin e fundit të programit.

	Pyetja	Sa konsultoheni nga Universiteti, gjatë përpilimit të programit të studimit? Sa merret parasysh inputi i juaj?	A merr te dhëna nga ju AKA ose MAShT për të shikuar përputhshmërinë e programeve me nevojat e tregut?	Sa mendoni se studentët janë të përgatitur për nevoja të kompanisë?	A keni nevojë t'i trajnoni të punësuarit tuaj për aftësitë jo të fituara nga arsimimi përkatës?	Nëse po, cilat aftësi ju mungojnë më së shumti të punësuarve që vijnë nga Fakulteti/drejtimi përkatës?	Cilat aftësi konkrete i nevojiten kompanisë dhe a janë të përfshira në program të studimit?	A gjeni dallim në aftësi mes studentëve që vijnë nga kolegjet private në krahasim me ata nga universitetet publike?	Nga cili lloj keni të punësuar më shumë studentë dhe pse?	A jeni të përfshirë në ndonjë formë brenda IAL-ve (si pjesë e bordit industrial ose këshillëdhënës).	Nëse po, a merrni pjesë në hartimin e deklaratës së misionit dhe vizionit, ose të planit strategjik?	A keni qenë të ftuar ndonjëherë si guest speaker nga Fakulteti përkatës apo nga ndonjë profesor për të ndarë përvojën tuaj me studentë?	Nëse po, sa herë? A keni ndonjë marrëveshje afatgjate apo vetëm ftesë çasti (një herë)?	A keni marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin/ Fakultetin për t'iu mundësuar studentëve punën praktike?	Nëse jo, a jeni të gatshëm të bëni marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin/ Fakultetin përkatës?
Gazetari	Kompania 1	Me aq sa kom informata unë dhe gjithë kompania, nuk jemi thirrë ndonjëherë në konsultim gjatë përpilimit të programit.	Jo.	Studentët dallojnë individualisht. Dituri praktike mbi gazetarinë nuk ka. Disa forma se si bëhet gazetaria nuk i dinë. Kur studentët vijnë prej një mësimi shumë teorik, nuk e kanë fleksibilitetin dhe kreativitetin për mënyrën se si shkojnë gjërat në gazetari. Gazetaria evoluon, programi i studimeve nuk evoluon aq shpesh. Në program mësohet për gazeta të shtypura, por në Kosovë nuk ka më shtyp. Mësojnë për faqosjen që nuk nevojitet më. Çalon komunikimi me palë. Si të shkruhet një email, si të qasemi në institucione. Diksioni mungon, si të qëndrohet para kamerës, si të flitet para kamerës, si të dukemi mirë para kamerës, si të dukemi më profesional. Nuk kanë TV apo pajisje në UP. Pozitive është që të paktën në gazetari në UP, studentët nisin punën që në vitin e parë. "Nëse nuk punësohesh deri në vitin e tretë, je i dështuar". Mediet kërkojnë njerëz të ri e energjik që duan të jenë gazetar.	Po i trajnojmë të gjithë gazetarët e ri që vijnë. Secila medie e ka mënyrën e vet të funksionimit. Secilit gazetar i nevojitet një periudhë provuese. Është ndërmarrësi komplekse. Personalisht i kam mentoruar rreth 20 gazetarë. Kanë nevojë për trajnim: se si me i identifiku lajmet, si strukturohet lajmi, çka e bënë të plotë lajmin, sa burime duhet të intervistohen nga të gjithë personat që janë të përfshirë në artikull. Trajnime të veçanta për paraqitje në TV. Truqet: për të raportuar para kamerës (stand up), paraqitjet që bëhen gjatë rrëfimit. Ka studentë që vijnë shumë të përgatitur, të cilët kanë pasur punë praktike diku tjetër.	Raportimi para kamerës, iu mungon praktika në fakultet. Mbledhja e të dhënave nga vendi i ngjarjes. Shkrimi analitik. Gazetaria e pavarur. Studentët nuk iu dërgojnë shkrime mediave për të matur veten nëse do t'iu publikohen, pra mungon guximi. Mungon bashkëpunimi i universitetit me medie. Njohuria në gjuhë të huaja si ajo angleze.	Për redaktim kanë nevojë të gjithë, jo vetëm studentët. Studentët nuk vijnë me aftësi të mira shkrimi, nuk e kanë shumë idenë e strukturës, apo mënyrës së rrëfimit. Është prej gjërave të para që trajnohet. Aftësia më problematike është komunikimi me palë, si qasemi në institucione, si i shkruajmë një politikani, si i qasemi personit për intervistë.	Një kolegj ka mundësi praktike për studentët, në krahasim me UP-në. Vijnë më të përgatitur në aspektin teknik të kamerave. Në aspektin e shkrimit, për një nuancë UP është më e mirë.	50 me 50, por me anim kah UP.	Jo në asnjë formë.	Jo.	Unë jo, mirëpo aq sa kam informata të tjerët nga mediumi jonë po. Kemi pasur bashkëpunim herë pas here, por nuk e di a ka qenë ftesë direkte nga UP. Në parim jo.	Ftesë çasti ka mundur të jetë.	Më herët më duket që ka pasur marrëveshje përmes një profesoreshe, që disa studentë të vijnë në praktikë. Ka qenë individuale si iniciativë e profesoreshës. Studentët nuk vijnë në praktikë për nevoja të fakultetit.	Po jemi.
	Kompania 2	Ne jo, asnjëherë. As në qendër të trajnimeve, as sa kam qenë redaktore.	Jo vetëm kemi pasur disa takime me Qendrën e Karrierës në UP. Jo në nivel të ministrisë e as të agjencisë.	Teorikisht janë relativisht mirë. Mirëpo në anën praktike çalojnë. Kanë mungesë të dijeve praktike. Për profesionet tipike që lidhen në radio, TV, etj. Qendra për aftësim profesional si lloj shkolle. Ndërkaq me EBU (european broadcasting union) veç gazetarët e kompanisë, kameramanë, producentë, etj.. I trajnojmë prej shkrimit të lajmit deri tek gazetaria prej telefonit. Ka edhe praktikë profesionale.	Automatikisht është pjesë e kontratës, që duhet me u trajnu. Gjithmonë kalojnë përmes fazës së trajnimit, përjashto rastet kur ka pasur përvojë pune. Ka trajnime të brendshme që vetë i organizojmë. Varet sipas rregullores, nëse merret si gazetar praktikant 3-6 muaj. Për studentë kemi disa pako 2 javë deri në 1 muaj, pastaj punë praktike deri në 1 vit.	Kryesisht janë aftësi praktike. Konkretisht është shkrimi i lajmit, problemi me njohjen e gjuhës. Struktura është problem serioz, në medie online kanë telashe. Programi është shumë I përgjithësuar.	Drejtshkrimi, të folurit qartë dhe bukur, paraqitja e mirë televizive. Probleme në të folur, përdorimi I dialekteve. Nuk mësohet produksioni. Nuk janë shumë bindës në radiogazetari.	Ne kemi më shumë gazetarë prej kolegjeve private. S'ka dallime të theksuara, për një nuancë kolegji privat është më i mirë për shkak të kushteve më të mira praktikisht janë më të aftësuar. UP vonë i ka marr pajisjet, por në teori janë më të mirë. Në shkrim janë më të dobët.	60% nga privatet, 40% nga publiket. Ne kemi pasur marrëveshje me X kolegjin për me i shkollu gazetarët e kompanisë pa diplomë. Menaxhmenti i ka vendosur.	Jo.	Jo.	Po në mënyrë jo formale. Me anë të përvojës së gazetarëve.	Ftesë çasti. 4-5 herë total.	Po kemi me katedrën e gazetarisë. Dekanati e dërgon listën, ju lejohet vetëm absoventëve për praktikën që iu duhet për kuota në studime. Por edhe individualisht vijnë. Ndodh që ne marrim praktikë shtesë nevojës obligative që e kanë. E kemi të nënshkruar marrëveshjen e cila përtërihet. Kemi edhe me minoritete.	N/A.
	Kompania 3	Zyrtarisht jo. Ka komunikim shumë të limituar me stafin akademik të programit.	Jo aspak. As agjencia e as ministria.	Ne marrim studenta, janë nën mesatare për TV, ndërsa për gazetë online janë më të përgatitur edhe pse shpesh mendojnë që duhet shkruar si për gazetë dhe se teksti në TV e në gazetë online duhet të jetë i vogël. Nuk e dinë që në tekstin për TV, mënyrat e deklaratës dallojnë (me shkrim, me telefon, me intervistë). Aspektin vizuel nuk dinë ta realizojnë; teknikën, xhirimi (bashkëpunimi me kameramanë), montimi, leximi – të gjitha çalojnë. Strukturën e lajmit e kanë të përzier me atë që praktikohet në gazeta, ndonëse nuk ka më gazetë të shtypur në Kosovë.	Po i trajnojmë, por nuk ka ndonjë trajnim formal sepse së pari punësohet si praktikant/e dhe javën e parë i dërgojmë në terren me gazetarë. Në strukturë të lajmit trajnohen, po ashtu në marrje të deklaratave. I trajnojmë edhe në koordinimin e pamjeve dhe lajmeve, si dhe në regji.	U mungon praktika teknike, realizmi i lajmit në terren, përgatitja e kronikës, terminologjia korrekte për kohët dhe vendin, paanshmëria për tendencat politike, emocionale, etnike, lokaliste, etj.	Nevojitet puna praktike me kamerë. Mendoj që programet e gazetarisë duhet të kenë mësimdhënës që kanë punuar në televizion.	Nuk ka ndonjë dallim substancial. Ata që kanë studiuar në kolegje private e kanë aspektin teknik pak më të avancuar.	90% nga universiteti publik, ndërsa pjesa tjetër nga kolegjet private.	As nga gazeta online e as nga televizioni.	Nuk jemi të përfshirë.	Po, unë dhe disa redaktorë të tjerë në televizione. Kanë ardhur edhe në studio me studentë. Herë pas here kemi vizita.	2-3 herë në vit. Me ftesë çasti.	Zyrtare nuk kemi. Por kryesisht i kemi studentët nga ata. Pra profesorët e programit i referojnë studentët tek ne.	Varet prej marrëveshjes. Nuk kemi kapacitet për shumë praktikantë, por jemi në rregull për një marrëveshje që është e përshtatshme për ne.

	Pyetja	Sa konsultoheni nga Universiteti, gjatë përpilimit të programit të studimit? Sa merret parasysh inputi i juaj?	A merr te dhëna nga ju AKA ose MAShT për të shikuar përputhshmërinë e programeve me nevojat e tregut?	Sa mendoni se studentët janë të përgatitur për nevoja të kompanisë?	A keni nevojë t'i trajnoni të punësuarit tuaj për aftësitë jo të fituara nga arsimimi përkatës?	Nëse po, cilat aftësi ju mungojnë më së shumti të punësuarve që vijnë nga Fakulteti/drejtimi përkatës?	Cilat aftësi konkrete i nevojiten kompanisë dhe a janë të përfshira në program të studimit?	A gjeni dallim në aftësi mes studentëve që vijnë nga kolegjet private në krahasim me ata nga universitetet publike?	Nga cili lloj keni të punësuar më shumë studentë dhe pse?	A jeni të përfshirë në ndonjë formë brenda IAL-ve (si pjesë e bordit industrial ose këshillëdhënës).	Nëse po, a merrni pjesë në hartimin e deklaratës së misionit dhe vizionit, ose të planit strategjik?	A keni qenë të ftuar ndonjëherë si guest speaker nga Fakulteti përkatës apo nga ndonjë profesor për të ndarë përvojën tuaj me studentë?	Nëse po, sa herë? A keni ndonjë marrëveshje afatgjate apo vetëm ftesë çasti (një herë)?	A keni marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin/ Fakultetin për t'iu mundësuar studentëve punën praktike?	Nëse jo, a jeni të gatshëm të bëni marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin/ Fakultetin përkatës?
Kompjuterike	Kompania 1	Kam pranuar ftesë por e kam refuzuar sepse unë e kam problem me kompjuterikë, 3 profesora i kanë 20 lëndë. Kur e pashë dokumentin që ishte edhe ftesë, u tërhoqa. Vitin e kaluar e kanë thirrë një tryezë, e cila ishte e dobët. D.m.th. në 20 vjet kjo ishte e vetmja herë që më kanë thirrë.	Jo asnjëherë.	Kryesisht pak të përgatitur. Ka disa studentë që janë tepër të mirë (individualisht).	Trajnimi zgjatë minimumi 3 deri në 6 muaj, por në shumicën e rasteve 6 muaj dhe kjo bëhet për gjëra kryesisht elementare.	50% aftësi gjenerale, si të sillen, si të dërgojnë email, pra aftësitë e buta apo aftësitë e lidhura me punën. 50% kanë mangësi teknike, nuk kanë ditur se çka është "front end, back end", ka raste që edhe e ka përfunduar lëndën por nuk ka qenë i njohur me këtë edhe pasi ka ardhur në kompani.	Aftësitë e nevojshme janë të përfshira në program, por nuk mësohen. Ne jemi më shumë me programim, softuer, por bëjmë edhe web. Aftësitë që i kanë në program, për shembull ky i sivjetmi, është tepër program i mirë në letër. Por studentët nuk i kanë as 5% të këtyre aftësive, nuk ka kush i mëson studentët. Do të mjaftonin njohuritë që ka programi në letër, ai nuk është problemi, por studentët nuk po i marrin ato aftësi. As aftësitë e përgjithshme nuk i dinë, p.sh. kush e kryen në Zagreb, është goxha i mirë, brenda 1 muaji i dinë gjërat, njëjtë si ata që i kanë përfunduar studimet në Sheffield, Kanada, Amerikë, por në UP janë të dobët.	Prej kolegjeve private gjen studenta, që në lëmi specifike janë shumë më të mirë se ata në universitete publike. Nuk i maltretojnë me lëndë shkencore si fizika, bazat, etj. Shumë studentë arrijnë më shumë me u përqendru ma shumë në diçka që ata e dojnë, p.sh. në programim. Nuk janë shume gjeneralista, dinë programim por jo diçka tjetër. Në UP, me programim më pak, por në të gjitha të tjerat qëndrojnë më mirë. Nëse do të marrësh inxhinier e merr prej elektros, sepse aty e kanë lodhur më shumë edhe ai di të mësojë gjithçka. Ndërsa në kolegje, mundesh me marr studentë me aftësi më të mira për programim. Herë më duhen inxhinier e herë programer.	Më duket që prej kolegjeve privateve kemi më shumë. Nuk kemi bërë ndonjë dallim, por sipas aplikimit. Disa kanë ardhur me referenca. Nuk fokusohemi në asnjërën prej institucioneve arsimore, e gjitha varet prej llojit të punës.	Jo nuk jam. Kohëve të fundit jemi ftuar joformalisht nga FIEK-u, por nuk kemi shkuar.	Jo.	Jo nuk më kanë ftuar universitetet publike, ndërsa nga kolegjet private më kanë ftuar pothuajse secila.	Jo.	Të shkruar nuk kemi por vijnë individualisht studentë për praktikën që iu nevojitet për fakultet. Referencë pas reference edhe vijnë, por jo nga fakulteti.	Në parim po.
	Kompania 2	Nuk jemi ftuar për konsultim, as si kompani e as personalisht. Ka 5 vite që kompania jonë është funksionale.	Jo nuk kanë marrë asnjëherë, as nga kompania e as personalisht.	Studentët në përgjithësi e marrin një bazë, sa i përket teorisë janë të mirë, në matematikë janë të mirë, ne e ndërtojmë mbi ta një profil të kompanisë. Direkt nevojat nuk i përmbushin. Në përgjithësi jemi të kënaqur me ta, ka përputhje, por ka ca teknologji të reja që janë në trendi e që nuk iu përcillen studentëve. Kompania jonë është kryesisht softuerike, punojmë me të dhëna, kemi produkt që është shumë i specializuar, bëjmë analiza të të dhënave, analiza zgjedhore, inxhinieri softuerike, 'data science.	Po kanë nevojë për trajnim, pavarësisht se prej cilit universitet vijnë, hyrja në kompani është tranzicion. Personi njoftohet me mënyrën e punës, pritshmëritë e kompanisë dhe ato të personit. Trajnimi është 1 muaj e gjysmë, por llogaritet që është kryer praktika, pastaj edhe 2 muaj dhe dalin se 'junior developer'. 1 muaj e gjysmë janë në trajnim/praktikë, fokusi total është praktikë. Deri tash janë 3 trajnime: 'front end', 'back end' edhe 'data engineering'. 2 perspektiva gjatë trajnimit: 1 si 'developer', 1 si 'data'. Kanë telashe në komunikim dhe në aftësi të buta, derisa të kyçen në ekip. Studentët nga kolegjet private kanë 'soft skills' shumë më të mira, krijojnë storie e shesin gjithçka, por programerat janë shume introverta, ka raste edhe që nuk dinë anglisht.	Nuk ndihen të lirë për të bërë pyetje, nuk janë mësuar të bëjnë shumë pyetje dhe të marrin përgjigje si "nuk e di". Kanë probleme me prezantim të punëve edhe gjuha angleze kohë pas kohe është problem. Ne në kompani kemi 'buddies', ai i tregon për përditshmërinë e punës studentëve të ri.	Programimi në 'Object Oriented Programming', 'Algoritme' dhe struktura e të dhënave, matematika, analiza (calculus e orientuar në praktikë), Algjebër (matematika diskrete) teori e grupeve, grafet, statistikë probabiliteti, teori e gjasës, programimi web (është gjeneral në fakultet) p.sh. nevojitet programimi në web mund të specifikohet, dhe 'mobile' duhet të futet prapë. 'Data science' përputhet me Matematikë Financiare. Dinë se si t'i nxjerrin njohuritë prej të dhënave, të aplikojnë algoritmet, modele matematikore, etj. FIEK-u në UP është i orientuar në harduer.	Soft skills' dinë më mirë studentët nga kolegjet private. Algoritmet qëndrojnë më mirë në FSHM, ndërsa ka kolegje që janë më të mira në kodim, por kolegjet private nuk po arrijnë me i mësu studentët për algoritme, ndërsa ata të FSHM mbërrijnë në nivelin e privateve. Gjithsesi FSHM-ja nuk e ka trendin e mirë.	50 me 50. Në trajnimin e fundit i kemi pasur 18 persona. Ata vinin kryesisht nga universitetet publike dhe disa nga privatet.	Jo, por planifikoj që t'iu propozoj që të përfshihem.	Jo.	Jo. Edhe kjo do të ishte shumë gjë pozitive nëse ndodhë. Fakultetet duhet të lidhen më shumë me industrinë.	Asnjëherë.	Jo nuk kemi. Kompanitë e vogla në Munchen merrnin punësonin kandidatët edhe gjatë studimeve. Ne kemi interes të marrim studentë në punë, por nevojitet shumë kohë dhe energji e madhe andaj nuk e kemi bërë ende. Pasi i përfundojnë studimet kemi marrë për praktikantë, p.sh ka raste që tema e Baçelor-it është bërë me ne.	Në të ardhmen kur të rritemi më shumë si kompani synojmë të marrim praktikantë për nevoja të studimeve të tyre.
	Kompania 3	Nuk kemi pranuar ndonjëherë kërkesë për konsultim apo diçka të tillë.	Jo as nga këto institucione nuk kemi pranuar ndonjë kërkesë apo ftesë, përveç Agjencisë së Statistikave të cilët kanë pasur pyetje jo relevante për programet funksionale.	Mesatarisht janë mirë të përgatitur. Besojmë se kompjuterika është duke i përgatitur jo vetëm për programim, por edhe për vegla të tjera mbështetëse.	Bëjmë trajnime të metodologjisë së punës. Edhe teknike dhe të organizatës së brendshme. Studentët kanë bagazh. Kur janë në praktikë rrijnë 3 muaj.	Njohuritë e përgjithshme me teknologji softuerike të reja, si enden datat, si merren, etj. Komunikimi 'soft skills' çalon – kjo është shumë e rëndësishme për organizatën, se si e merr një kërkesë, si e merr një punë, si e dorëzon detyrën, etj. Edhe në gjuhë angleze mendoj se duhet të përmirësohen.	80% të gjuhëve janë të përfshira në program të studimit, mirëpo nevojitet më shumë kulturë organizative.	Nga universitet publike kanë më shumë njohuri të përgjithshme (deep thinking), përndryshe kryesisht janë të njëjtë edhe me ata të kolegjeve privateve.	Nga universitetet publike janë shumica dërrmuese.	Nuk jemi të përfshirë, as si kompani e as personalisht dhe për këtë gjë nuk kemi marr ndonjëherë ftesë.	Jo.	Jo.	0	Nuk kemi ndonjë marrëveshje formale, mirëpo kemi kontakte me një profesor, studentët e të cilit vijnë tek ne për të përfunduar edhe praktikën.	Sigurisht. Me shumë kënaqësi.

	Pyetja	Sa konsultoheni nga Universiteti, gjatë përpilimit të programit të studimit? Sa merret parasysh inputi i juaj?	A merr te dhëna nga ju AKA ose MAShT për të shikuar përputhshmërinë e programeve me nevojat e tregut?	Sa mendoni se studentët janë të përgatitur për nevoja të kompanisë?	A keni nevojë t'i trajnoni të punësuarit tuaj për aftësitë jo të fituara nga arsimimi përkatës?	Nëse po, cilat aftësi ju mungojnë më së shumti të punësuarve që vijnë nga Fakulteti/drejtimi përkatës?	Cilat aftësi konkrete i nevojiten kompanisë dhe a janë të përfshira në program të studimit?	A gjeni dallim në aftësi mes studentëve që vijnë nga kolegjet private në krahasim me ata nga universitetet publike?	Nga cili lloj keni të punësuar më shumë studentë dhe pse?	A jeni të përfshirë në ndonjë formë brenda IAL-ve (si pjesë e bordit industrial ose këshillëdhënës).	Nëse po, a merrni pjesë në hartimin e deklaratës së misionit dhe vizionit, ose të planit strategjik?	A keni qenë të ftuar ndonjëherë si guest speaker nga Fakulteti përkatës apo nga ndonjë profesor për të ndarë përvojën tuaj me studentë?	Nëse po, sa herë? A keni ndonjë marrëveshje afatgjate apo vetëm ftesë çasti (një herë)?	A keni marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin/ Fakultetin për t'iu mundësuar studentëve punën praktike?	Nëse jo, a jeni të gatshëm të bëni marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin/ Fakultetin përkatës?
Banka	Kompania 1	Së fundmi me kolegje private, kemi biseduar për bashkëpunim në planin e punës të programit. Ka qenë edhe një prezantim njëherë në të cilin kemi dhënë komente por nuk e di se sa janë marrë parasysh. Kolegjet private goxha janë munduar të na përfshijnë gjatë përpilimit të programeve.	Nuk marrin ndonjë të dhënë prej nesh sepse nuk na kanë kontaktuar.	Pak. Në aspektin teorik ka shumë hapësirë për përmirësime. Nuk janë në nivelin e studentëve që mund të flasësh për sisteme bankare. Studenti duhet të ketë potencialin të mësojë por duhet të ketë edhe aftësi të buta, të cilat nuk i kanë në nivelin e duhur. I trajnojmë për kulturën organizative, komunikimin, iniciativën. 1 në 10 janë të mirë, që i përmbushin nevojat bazike. Mungon aftësia e shërbimit të klientit.	Trajnimi bëhet në vendin e punës, i mësojnë parimet e para bankare. Pra çdoherë kemi nevojë t'i trajnojmë sepse nuk e dinë as çka është banka, niveli i nocionit është shumë i dobët. Kjo vjen si rezultat i asaj që njerëzit që punojnë në industri nuk janë pjesë e universiteteve.	Prioritet e kemi potencialin, kureshtjen për të mësuar sepse u mungon kureshtja. Nuk kanë vizion për karrierë, nuk kanë shprehi të punës. Kanë mangësi në marrjen e përgjegjësisë mbi vete në menaxhimin e kohës. Nuk kanë aftësi teknike, nuk njohin punën në Excel apo paketën e MS Office. Internetin nuk e shfrytëzojnë për të marrë informata. Kolegjet private në këtë aspekt janë më të përgatitura, kanë më shumë ndërveprime, bëjnë prezantime kanë debate dhe komunikim më të mirë, e njohin më shumë paketën MS Office. Anglishten e kanë 3 nga 10.	I presim në intervistë që të diskutojmë në nivel profesional, të cilin nuk e kanë. Nuk dinë të diskutojnë për ekonomi, se si bankat ndikojnë në ekonomi, shoqëri, përgjegjësi të korporatave. Studentët tek pas disa viteve i kuptojnë këto aftësi. Me Fakultet Ekonomik kur janë nuk dinë. Nuk dinë a janë asete apo detyrime, kursimet për bankën. Nuk kanë aftësi për zgjidhjen e problemeve analitike, komunikim, etj.	Varet prej programeve. Në aftësi të buta janë më të mira kolegjet private sepse punojnë në grupe, i shtyjnë të mendojnë. Në publike punojnë shumë më shumë për një notë, rrjedhimisht janë më punëtorë dhe më përpjekës.	Tash 2 vitet e e fundit janë 50/50, sepse kolegjet private I janë afruar bankës për të pasur bashkëpunim duke i punësu studentët e tyre. Kolegjet private kanë qenë më të dedikuar, ndërkohë që universiteteve publike duket se nuk u intereson.	Nuk jemi të përfshirë.	Jo.	Po kemi qenë disa herë. Në UP p.sh. Që nga nënshkrimi I marrëveshjes me qendrën e karrierës(QZHK). Tentohet të bëhet ndërlidhja e praktikës me përvojë dhe teori. Kemi shkuar edhe në fakultet, edhe në QZHK.	Së paku një herë në vit në publike, ndërsa me kolegjet private kemi marrëveshje afatgjatë. Me UP nuk kemi, është vetëm praktikë e bashkëpunimit. Ata na ftojnë në të gjitha panairet, kur ka tema për studentë të tyre por më shumë shkojmë për nevoja tona. Kur na duhet studentë në bankë, bursista apo studentë që na duhen për projekte, marrim lista të studentëve të cilët i përzgjedhim. Rekrutim nga universiteti, pra marrim një student dhe e zhvillojmë për fusha specifike.	Për punë praktike po kemi marrëveshje, pra kryesisht punë praktike për punësim. Ka edhe për kredi për praktikën që nevojitet. Është pjesë e marrëveshjes.	Jemi të gatshëm për marrëveshje të ngjashme si ato që I kemi.
	Kompania 2	Kam përvojë 14 vjeçare dhe vetëm para 1 viti, pak para pandemisë një profesor në programin e nivelit Master (plan me bankën qendrore), na ka ftuar për të folur rreth nevojës për këtë profil në një panel me të huaj. Kjo ftesë ishte ad-hoc, sa për t'i mbështetur. Kjo ka qenë kur i kanë pasur ekspertët e akreditimit prezent, pra kërkonin input nga ne por kjo nuk ishte e planifikuar më herët.	Jo asnjëherë.	Pak të përgatitur, që të mos themi aspak. Kanë njohuri teorike, por nuk e njohin rolin e bankave. Ngecin shumë, nuk kanë asnjë njohuri praktike të gjitha teorike, ata çalojnë në gjëra bazike se si funksionon banka, çfarë është banka. Aftësitë e tjera po ashtu janë shumë të ulëta. p.sh. në gjuhë angleze janë shumë të dobët. Departamenti banka dhe financa ka ngecje të mëdha, studentët nuk kanë aftësi të mendimit kritik për ato që i mësojnë.	Kryesisht marrim kandidatë që kanë potencial, por që nuk kanë aftësi. Trajnohen për 6 muaj, nga to 3 muaj kryesisht diskutohet për tema jo vetëm bankare por edhe të tjera si etika në punë, mendimi kritik, matematika financiare, sistemi bankar. Marrin kontratë pune që nga fillimi, punësohen por nuk punojnë.	Kryesisht nuk e njohin punën e bankave. Testohen logjikisht dhe në matematikë, rreth 5 apo 6 kandidat e kalojnë testimin. Nuk ka ndodhë ende që prej Kosovës të vijnë studentë që i njohin 3-4 elemente bazike me të cilat operojnë bankat, ndërkaq prej shteteve të tjera kur vijnë ka.	Kompanisë i nevojiten kandidatë që kanë aftësi për mendim kritik, matematikë, logjikë, etj. Studentët deri tani nuk kanë pasur njohuri praktike për kontabilitet, kanë problem me aftësi të buta, me gjuhën angleze. Ndonëse Kontabiliteti është lëndë që mësohet në program studentët çalojnë shumë.	Në Kosovë, kolegjet private qëndrojnë shumë më keq se universitetet publike, me përjashtim të X kolegjit. Ata janë më të përgatitur sepse kolegjet e tjera private qëndrojnë shumë keq.	Ne punësojmë më shumë studentë nga universitetet publike.	Jo nuk jemi. Ka pasur ca iniciativa nga ish rektori I UP-së por prapë se prapë nuk jemi.	Jo.	Po shpesh, por më shumë me kërkesë të bankës tonë. Sidoqoftë shumë pak profesorë përfshihen.	Jemi ftuar në gjatë ligjëratave të disa profesorëve. Ne kemi marrëveshje me rektoratin e UP-së dhe sa herë kemi kërkuar lista të bursistëve janë përgjigjur menjëherë, sidomos zyra për zhvillim të karrierës. Pra kemi pasur më shumë përgjigje ndaja kërkesave tona se sa iniciativë nga ta edhe pse marrëveshja ekziston me nivelin qendror të universitetit.	Pjesë e marrëveshjes është që banka të përkrah dhe t'i punësojë studentët sipas nevojave dhe kritereve të bankës. Ne marrim deri në 100 studenta në vit, si praktikant. 20 prej tyre mund të arrijnë të kyçen në program të punësimit (trajnim), ata paguhen 200 euro.	Ka marrëveshje.

	Pyetja	Sa konsultoheni nga Universiteti, gjatë përpilimit të programit të studimit? Sa merret parasysh inputi i juaj?	A merr te dhëna nga ju AKA ose MAShT për të shikuar përputhshmërinë e programeve me nevojat e tregut?	Sa mendoni se studentët janë të përgatitur për nevoja të kompanisë?	A keni nevojë t'i trajnoni të punësuarit tuaj për aftësitë jo të fituara nga arsimimi përkatës?	Nëse po, cilat aftësi ju mungojnë më së shumti të punësuarve që vijnë nga Fakulteti/drejtimi përkatës?	Cilat aftësi konkrete i nevojiten kompanisë dhe a janë të përfshira në program të studimit?	A gjeni dallim në aftësi mes studentëve që vijnë nga kolegjet private në krahasim me ata nga universitetet publike?	Nga cili lloj keni të punësuar më shumë studentë dhe pse?	A jeni të përfshirë në ndonjë formë brenda IAL-ve (si pjesë e bordit industrial ose këshillëdhënës).	Nëse po, a merrni pjesë në hartimin e deklaratës së misionit dhe vizionit, ose të planit strategjik?	A keni qenë të ftuar ndonjëherë si guest speaker nga Fakulteti përkatës apo nga ndonjë profesor për të ndarë përvojën tuaj me studentë?	Nëse po, sa herë? A keni ndonjë marrëveshje afatgjate apo vetëm ftesë çasti (një herë)?	A keni marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin/ Fakultetin për t'iu mundësuar studentëve punën praktike?	Nëse jo, a jeni të gatshëm të bëni marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin/ Fakultetin përkatës?
Elektroenergjetike	Kompania 1	Formalisht nuk kemi pasur ndonjë kërkesë për përfshirje. Ne kemi disa punëtorë që punojnë në elektroenergjetikë dhe kanë mundur të kontribuojnë por jo drejtpërdrejtë.	Nuk kanë na kanë kontaktuar as Agjencia e Ministria. Në akreditim institucional jemi ftuar nga UP. Ndërkaq në FIEK eksperti i jashtëm na ka pyetur rreth riakreditimit të programit të elektroenergjetikës. Pyetjet kanë qenë të natyrës "sa jeni të kënaqur me studentët që dalin nga ky universitet", dhe a jemi të përfshirë në program të studimit.	Studentët që ne i kemi janë në përgjithësi nga elektroenergjetika. Në aspektin e teorisë janë të përgatitur mirë, por kanë vështirësi me i apliku në botën reale. Janë të përgatitur mirë në përdorim të teknologjisë dhe gjuhëve të huaja. Telashe kanë me njohje të pajisjeve. I marrim studentët e vitit të tretë, njëkohësisht që janë duke studiuar, dhe nëse e kryjnë mirë trajnimin punësohen. Numri më i madh i atyre që janë punësu në kompani është mbi 52%, por ka edhe të atillë që vazhdojnë në studimet master. Tash e kemi gjeneratën e 7 i kemi punësuar të gjithë (20).	Ka 8 gjenerata që ekziston qendra e trajnimit dhe për 6 muaj është praktike jo intensive. Modulet janë të orientuara nga natyra e punës.	Aplikimi në praktikë i shkathtësive, përshtatja me ambientin e punës në terren, aftësitë e buta, u mungon pjesa e organizimit të projekteve, komunikimit.	Inxhinieria teorike ekziston, me trajnime shtesë, dhe përkrahja e stafit të vjetër i mbulon. Ndoshta programet aktuale duhet të kenë plotësim-ndryshim. Teknologjinë SCADA nuk e njohin studentët.	Në aftësitë e buta më të mirë janë studentët nga kolegjet private, inxhinieri kompjuterike softueri. Ndërkaq në aspektin inxhinierik janë goxha më mirë studentët nga universitetet publike (shumë më larg privateve) – shumë lehtë përshtaten.	Të gjithë gati pothuajse janë nga FIEK-u nga programi elektroenergjetikë.	Jo as formalisht as në ndonjë mënyrë tjetër.	Jo.	Përveç atyre që janë të angazhuar nuk është ftuar dikush. Kemi përfaqësues kur ka prezantime apo punime në konferenca, por jo si folës të ftuar për të treguar përvojën karshi studentëve.	Formalisht asnjëherë, përveç rasteve të mësipërme.	E kryejnë praktikën e fakultetit tek ne, përmes fakultetit por edhe vetë studentët vijnë me iniciativë të tyre. Kemi pasur marrëveshje me UP-në nga të gjitha fakultetet, por vitin e fundit nuk e kemi përtërirë. Marrëveshja thotë që UP i ofron studentët, kompania mbulon shpenzimet, e kryejnë praktikën i fitojnë kreditë të mbrojnë praktikën së bashku me ne (2 nga kompania, 1 nga universiteti). Gjithmonë iniciativat janë nga ana e kompanisë, si me MASHTI si me universitetin.	Veçse ka.
	Kompania 2	Si kompani drejtpërdrejtë nuk jemi. Përmes stafit që kemi brenda e që janë bashkëpunëtor, ka input. Nuk jemi ftuar asnjëherë për këtë gjë. Prej 2018 jam në burime njerëzore. Në elektroenergjetikë në 2019 ka qenë një punëtori në raport me tregun e punës me kuadrot dhe rektorin e UP-së në QZHK.	Ja nuk na kanë ftuar. Kur ka qenë periudha e akreditimit, kemi shkuar në fakultet dhe është mbajtur një takim virtual me ekspertin bullgar ose rumun të akreditimit mes neve të energjetikës. Në takim nuk ka pasur as profesorë përveç kompanive që merren me elektroenergjetikë.	Kanë përgatitje të mirë në aspektin e përgjithshëm të inxhinierisë. Programi është i mjaftueshëm për ta ndërlidhur teorinë me praktikën.	Inxhinierët me përvojë janë si mentor të praktikantëve. Studentët kanë njohuri të përgjithshme, por kanë nevojë për konkretizim të teorisë. Praktika profesionale nga fakulteti është shumë e shkurtë, dhe shumë e ngushtë, kanë nevojë për përvetësimin e metodave të punës, bashkëpunimit deri tek puna e pavarur. Mentori pastaj siguria në punë pastaj edhe trajnime të tjera. Bëjmë punëtori të jashtme, por edhe nga vet stafi i brendshëm, kemi trajnime në baza vjetore për stafin.	Studentët kanë nevojë për zhvillim të aftësive për punë të pavarur. Kalimi përmes skemës e vizatimeve, në punë reale fizike. Prej fakultetit në nënstacion, i nevojitet të trajnohet. Nuk i njohin pajisjet fizike, në praktika të planifikimit çalojnë, kanë nevojë për trajnim. Fazat e përdorjes së pajisjeve (planifikimi, etj). Operimi në kohë reale çalon, mirëmbajtja e sistemit të transmetimit, zhvillimi i projekteve, aplikimi i softuerëve për kontrollë, testim mbrojtje, etj. Me zhvillimin e teknologjisë, nevoja për trajnime është e vazhdueshme.	Përgatitja e tenderdosjeve. Zhvillimi i tregut të energjisë. Burimet e ripërtrishme të energjisë, sepse kompania është në transmision. Impakti në mjedis. Aftësi të tjera përveç atyre që u përmenden tek pyetja më sipër (stabilimentet fizike). Përveç lëndëve bazike, ka edhe 12 lëndë që kontribuojnë të cilat ndërlidhen direkt me nevoja të kompanisë. Në përgjithësi programi Elektroenergjetika në UP përshtatet me kompaninë tonë.	Një kolegj privat ka një ngjashmëri programi të emëruar Energjia elektrike, ne e pranojmë studentin nga ai program dhe administrimi është më i shprehur te kolegjet private. Në publike është inxhinieria. Nganjëherë kolegji është në përparësi edhe pse aktualisht nuk kemi studentë nga kolegjet private. Shkencat kompjuterike janë më të shprehur, shkenca jo teknike po ashtu, në aspektin e programimit më tepër shkon në favor të kolegjeve private. Elektroenergjetika në universitete publike është shumë më e mirë.	Nuk kemi të punësuar nga kolegjet private që vijnë nga programet elektro po kemi nga shkencat kompjuterike.	Jo nuk jemi.	Jo.	Jo. Ka disa vite që dikush prej kolegëve ka qenë në një kolegj privat, në një ligjëratë në kuadër të studimeve verore.	Vetëm ftesa individuale të kolegëve.	Kemi marrëveshje me FIEK-un në UP dhe Kolegjin X, pra memorandum mirëkuptimi. Mundësojmë praktikë profesionale edhe për studentët e profileve të tjera, nëse kemi akomodim edhe nëse nuk kemi marrëveshje. Kemi 2 lloj praktikash, praktikë që bazohet në kurrikulë (të lëndëve), 120 orë praktike në 3 javë ose 1 muaj nëse janë të ndërtimtarisë. Qoftë si absolvent, qoftë si master. Praktika tjetër është 3-6 muaj, varet prej projekteve. Kemi marrëveshje për bursa, ka konkurs kompania sipas kritereve të tij, komisioni është i përbashkët dhe kemi 10 bursa për momentin. Nuk mund t'i kushtëzojmë që të vijnë në kompaninë tonë, por shumica vijnë dhe punësohen. Praktikën profesionale gjithsesi e kryejnë tek ne.	n.a







ORCA është anëtare e Koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet - KITU, mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur - KFOS. Ky raport është pjesë e programit të KITU-së. Ky grant është financuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Përmbajtja është përgjegjësi e ORCA dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i KFOS-it.